FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 109

Tiranë – E hënë, 15 maj 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 25, datë 3.5.2017	Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare"	5845
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 26, datë 3.5.2017	Për miratimin e udhëzimit "Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit"	5848

VENDIM
Nr. 25, datë 3.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të nenit 53 pika 4, të shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 55, të nenit 56 pika 2, neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", miratuar me vendimin nr. 59, datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Përmbajtja e nenit 4 ndryshon si më poshtë vijon:

i) në pikën 1, pas togfjalëshit "të ligjit "Për bankat"", shtohet togfjalëshi "dhe në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare"";

b) Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) përpara pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"1/1. Bankat, në rregulloret dhe procedurat e brendshme të veprimtarisë, përfshijnë ndër të tjera edhe rregullat për transparencën ndaj klientit."

ii) në pikën 3, togfjalëshi "komisionet dhe gjobat (penalitetet)", ndryshon në "komisionet dhe penalitetet";

iii) pika 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"4. Bankat, në rastet kur ndryshojnë kushtet e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare apo financiare, njoftojnë:

a) në mënyrë individuale, secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve, sipas afatit dhe formës së përcaktuar në kontratën ndërmjet palëve (me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike) dhe të dokumentuar nga banka; si dhe

b) nëpërmjet afishimit të njoftimeve ose broshurave në ambientet e bankës, në faqen zyrtare të internetit ose me mjetet e komunikimit masiv.

Ky njoftim kryhet të paktën 15 ditë përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme. Njoftimi duhet të përmbajë informacion të saktë, të plotë dhe të shprehur në një gjuhë të kuptueshme për klientin. Në çdo rast, kushtet e kontratës nuk mund të ndryshohen pa u dhënë pëlqimi i klientit sipas përcaktimeve të kontratës."

iv) pika 5 shfuqizohet;

c) Përmbajtja e nenit 6 ndryshon si më poshtë vijon:

i) në pikën 3, togfjalëshi "Shpenzimet e mbajtjes së një llogarie", ndryshon në "Shpenzimet e hapjes dhe mirëmbajtjes së një llogarie" dhe togfjalëshi "nëse janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të veçantë në marrëveshjen e kredisë ose në ndonjë marrëveshje tjetër, të përfunduar me klientin", zëvendësohet me "nëse hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë janë të detyrueshme për të përfituar kredinë ose për ta përfituar atë sipas kushteve të rëna dakord";

ii) në pikën 5, togfjalëshi "në lidhje me nivelin fillestar dhe do të mbeten të aplikueshme deri në fund të marrëveshjes së kredisë", zëvendësohet me "në lidhje me nivelin e përcaktuar në datën e nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë";

d) Përmbajtja e nenit 7 ndryshon si më poshtë vijon:

i) në pikën 1, shkronja "c", pas togfjalëshit "vlerën periodike të shlyerjes së kredisë (kësti)", shtohet togfjalëshi ", metodën e llogaritjes së kështit të kredisë";

ii) në pikën 2, togfjalëshi "banka i ofron kredimarrësit", zëvendësohet me "banka i vë në dispozicion kredimarrësit dhe përfshin në dosjen e kredisë, një kopje të firmosur të këtij informacioni";

iii) në pikën 2, shkronja c, fjala "mënyrës", zëvendësohet me "metodës".

e) Përmbajtja e nenit 8 ndryshon si më poshtë vijon:

i) pika 1, paragrafi i parë ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"1. Banka, në rast të aplikimit të një norme të ndryshueshme interesi, i siguron kredimarrësit, sipas formës së përcaktuar në kontratën ndërmjet palëve (me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve

telefonike), të paktën një herë në 12 muaj, informacionin e mëposhtëm:";

ii) në pikën 3 shkronja "d", togfjalëshi "ose metodën e llogaritjes së saj", ndryshon në "si dhe metodën e llogaritjes së saj";

iii) në pikën 3 shkronja "f", pas togfjalëshit "kur dhe pas", shtohet togfjalëshi "së cilës";

iv) në pikën 3 shkronja "g", fjala "gjobat", zëvendësohet me "penalitetet";

v) në pikën 4, togfjalëshi "përveç informacionit sipas shkronjave "a" dhe "c" të paragrafit 3 të këtij neni", zëvendësohet me "përveç informacionit sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 3 të këtij neni";

vi) në pikën 4, shkronja "a" shfuqizohet;

vii) në pikën 4, shkronja "c", nënpika "iii", pas togfjalëshit "e cila nuk është paguar në kohën e duhur", shtohet togfjalëshi "dhe metoda e llogaritjes së shumës që detyrohet të paguajë klienti".

f) Përmbajtja e nenit 9 ndryshon si më poshtë vijon:

i) në pikën 2, përmbajtja e shkronjës "a", "norma e interesit dhe mënyra e llogaritjes së saj", ndryshon në "norma e interesit";

ii) në pikën 2, përmbajtja e shkronjës "b", "frekuenca e pagesave të interesit", ndryshon në "metoda e llogaritjes dhe frekuenca e pagesave të interesit";

iii) në pikën 2, shkronja "e", fjala "gjoba", zëvendësohet me "penalitete";

iv) në pikën 2, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "f" me përmbajtjen e mëposhtme:

"f. kriteret/kushtet për klasifikimin e llogarive në statusin "jo aktive" dhe kostot financiare të rikthimit të tyre në statusin "aktive"";

v) në pikën 3, përmbajtja e shkronjës "c", "shumat e interesit dhe frekuenca e pagesës së tyre", ndryshon në "shuma e interesit, metoda e llogaritjes dhe frekuenca e pagesës së saj";

vi) në pikën 3, përmbajtja e shkronjës "g", "kushtet e anulimit (prishjes) të kontratës; dhe", ndryshon në "kushtet e zgjidhjes para afatit të përfundimit të kontratës; dhe";

vii) në pikën 3, përmbajtja e shkronjës "h", "penalitetet e aplikueshme në rastin e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës.", ndryshon në "penalitetet e aplikueshme në rastin e zgjidhjes para afatit të përfundimit të kontratës.";

viii) përmbajtja e pikës 4, ndryshon si më poshtë vijon:

"4. Banka duhet të parashikojë në kontratën e llogarisë rrjedhëse dhe të kursimit, mënyrën e njoftimit të klientit për ndryshimin e kushteve të kontratës së nënshkruar, para se të aplikojë ndryshimin.";

ix) pika 5 shfuqizohet.

g) Në nenin 11 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

i) në pikën 2, fjala "paragrafit", zëvendësohet me "pikës".

h) Përmbajtja e nenit 12 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Banka harton procedura dhe rregulla të brendshme për trajtimin e ankesave të klientëve, duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen e tyre.

2. Banka i siguron klientit informacionin e nevojshëm mbi procedurat për trajtimin e ankesave në mënyrë të shpejtë dhe të plotë.

3. Në rastin e një ankese me shkrim nga klienti, banka duhet t'i japë përgjigje me shkrim klientit mbi ankesën, brenda afatit kohor të përcaktuar në aktet e brendshme rregullative të bankës ose në kontratën përkatëse ndërmjet klientit dhe bankës.

4. Banka evidenton në një regjistër të veçantë, të dhëna për çdo ankesë të klientëve që ka lidhje me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, informacion mbi zgjidhjen e këtyre ankesave, si dhe të dhëna të tjera plotësuese të nevojshme.

5. Struktura përgjegjëse për trajtimin e ankesave të klientëve përgatit në baza periodike një raport përmbledhës për organet drejtuese të bankës, mbi numrin, tipologjinë dhe zgjidhjet e ankesave të paraqitura nga klientët e bankës.".

i) Emërtimi dhe përmbajtja e nenit 13 ndryshon si më poshtë vijon:

"Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të parashikuara në ligjin "Për Bankat" dhe në aktet e tjera nënligjore, në zbatim të tij.".

j) Në Aneksin 1, përmbajtja e seksionit "Metoda e llogaritjes së normës efektive të interesit për kredinë", ndryshon si më poshtë vijon, si dhe shtohet seksioni "Disa supozime shtesë mbi llogaritjen e NEI-t", sipas përmbajtjes së aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

ANEKS NR.1

METODA E LLOGARITJES SË NORMËS EFEKTIVE TË INTERESIT PËR KREDINË

Ekuacioni bazë, për llogaritjen e normës efektive të interesit (NEI), barazon, mbi një bazë vjetore, nga njëra anë vlerën totale aktuale të kredisë (total present value of drawdowns), duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj.), të vënë në dispozicion të klientit, sipas marrëveshjes së kredisë dhe në anën tjetër, vlerën totale aktuale të shlyerjeve dhe/ose pagesave të shpenzimeve (total present value of repayments and payments of charges):

$$\sum_{k=1}^{m} Kk\,(1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} Rl\,(1+i)^{-tl}$$

Kuptimi i shkronjave dhe simboleve:

i (NEI) – është norma efektive e interesit, e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur nga kontrata ose ndryshe.

m - është numri total i kësteve të lëvrimit të kredisë, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste (drawdowns), të paguar nga kredidhënësi.

k - është kësti i k-të i kredisë i lëvruar nga kredidhënësi (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste), kështu që $1 \leq k \leq m$.

Kk - është vlera e kështit të kredisë (drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (të lëvruar) në periudhën k.

tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të kështit të parë të kredisë (first drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë t1 = 0.

m' - është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.

l - është pagesa e l-të e kryer nga klienti për shlyerjen e kredisë ose pagesën e shpenzimeve.

Rl - është vlera e kështit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l.

tl - intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të kështit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së lëvrimit të kredisë (në rast se lëvrimi i kredisë bëhet i plotë) dhe datës së çdo kësti për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.

Shënime:

a) Shumat e paguara nga të dyja palët në kohë të ndryshme nuk është e nevojshme të jenë të barabarta dhe të paguhen në intervale të barabarta.

b) Data e fillimit duhet të jetë ajo e lëvrimit të kështit të parë të kredisë nga banka, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste ose e datës së lëvrimit të kredisë, në rast të lëvrimit të plotë të kredisë.

c) Intervalet midis datave të përdorura në llogaritje duhet të shprehen në vite ose fraksione të vitit. Një vit presupozohet të ketë 365 ditë ose 366 ditë për vitet e brishtë, 52 javë ose 12 muaj. Një muaj presupozohet të ketë 30,41666 ditë (365/12), pavarësisht nëse është ose jo vit i brishtë.

Nëse intervalet midis datave të përdorura në llogaritje, nuk mund të shprehen si një numër i plotë javësh, muajsh ose vitesh, intervalet duhen të shprehen si një numër i plotë i këtyre periudhave i kombinuar edhe me një numër ditësh.

Kur përdoren ditët:

i) çdo ditë përfshihet në llogaritje, përfshirë edhe ditët e fundjavës apo të pushimit;

ii) periudhat e barabarta dhe më tej, ditët duhet të llogariten në rend zbritës deri në datën e lëvrimit të parë;

iii) kohëzgjatja e periudhës duhet të llogaritet duke përjashtuar ditën e parë dhe duke përfshirë ditën e fundit dhe do të shprehet në vite, duke e pjesëtuar këtë periudhë me numrin e ditëve (365 ose 366 ditë) të një viti të plotë, të llogaritura në rend zbritës nga dita e fundit, deri në të njëjtën ditë të vitit të mëparshëm.

d) Rezultatet e llogaritjes duhet të shprehen me një saktësi, të paktën një shifër pas presjes dhjetore.

e) Ekuacioni mund të rishkruhet duke përdorur një shumë të vetme në rast të lëvrimit të plotë të kredisë nga banka:

$$S=\sum_{l=1}^{m'} Rl\,(1+i)^{-tl}$$

S - është vlera totale aktuale e kredisë (total present value of drawdowns), duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj).

Bankat duhet të sigurojnë që metodat e zgjidhjes së aplikueshme të japin një rezultat të barabartë me atë të shembujve të paraqitur në këtë aneks (shih më poshtë).

Disa supozime shtesë mbi llogaritjen e NEI-t

1. Nëse një kontratë kredie i jep të drejtën klientit për të tërhequr fondet në çdo kohë, do të supozohet që vlera e kredisë tërhiqet menjëherë dhe në total.

2. Nëse një kontratë kredie parashikon mënyra të ndryshme tërheqjeje nëpërmjet aplikimit të komisioneve dhe normave të ndryshme të interesit, do të supozohet që vlera totale e kredisë tërhiqet me komisionin më të madh dhe me normën më të lartë të interesit të zbatueshme për formën më të zakonshme të tërheqjes të këtij lloji kontrate kredie.

3. Nëse një kontratë kredie i jep klientit të drejtën e tërheqjes në përgjithësi të fondeve, por vendos, midis mënyrave të ndryshme të tërheqjes, një kufizim për shumën dhe periudhën kohore, do të supozohet që shuma e kredisë tërhiqet në datën më të hershme të parashikuar në marrëveshje dhe në përputhje me kufirin e tërheqjeve.

4. Nëse në kontratë parashikohen komisione dhe norma të ndryshme interesi për një shumë ose periudhë të caktuar, si normë interesi dhe komision për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë, do të konsiderohet norma dhe komisioni më i lartë i parashikuar.

5. Në kontratat e kredisë për të cilat është vendosur një normë fikse interesi në lidhje me periudhën fillestare, në fund të së cilës është vendosur një normë e re huamarrjeje dhe që më pas ndryshohet periodikisht sipas një indeksi orientues të rënë dakord, llogaritja e NEI-t do të bazohet në supozimin që, në fund të periudhës me normë fikse interesi, norma e interesit do të jetë e njëjtë si në momentin e llogaritjes së NEI-t, bazuar në vlerat e indekseve orientuese të rëna dakord në atë moment, por nuk mund të jetë më e ulët se norma fikse e interesit.

6. Nëse në një kontratë kredie (për kredinë kufi ose kartat e kreditit) nuk është përcaktuar kufiri i saj, do të supozohet që ky kufi është 200,000 lekë ose kundërvlefta në monedhë të huaj.

7. Në rastin e kontratës për kredi kufi (overdraft), do të supozohet që kredia është tërhequr në total dhe për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës së kredisë. Nëse nuk dihet kohëzgjatja e kontratës së kredisë kufi, NEI do të llogaritet duke supozuar që kohëzgjatja e kredisë është tre muaj.

8. Nëse nuk ka një plan fiks pagesash, do të supozohet që:

a) kredia jepet për një periudhë njëvjeçare; dhe/ose

b) kredia do të paguhet me 12 këste të barabarta mujore.

9. Nëse ka një plan fiks pagesash për shlyerjet, por shuma e pagesave është e ndryshueshme, do të supozohet që shuma e secilës pagesë është më e vogla nga vlerat që parashikon kontrata.

10. Me përjashtim të rasteve në të cilat është përcaktuar ndryshe, kur kontrata e kredisë parashikon më shumë se një datë shlyerjeje, do të supozohet që kredia bëhet e disponueshme dhe pagesat kryhen në datën më të hershme të parashikuar në kontratë."

VENDIM
Nr. 26, datë 3.5.2017

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe nenit 57, pika 1, 2, 4, 5 dhe nenit 59 pika 4 të ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin "Mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së

kapitalit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të udhëzimit, si dhe për paraqitjen e raportit të procesit të vlerësimt të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit në Bankën e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes) me të dhënat e fundvitit 2017 dhe sipas afatit të përcaktuar (30 prill 2018).

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 dhjetor 2017.

KRYETARI
Gent Sejko

1. Të përgjithshme

1.1. Qëllimi i udhëzimit

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave për bankat mbi hartimin dhe zbatimin e Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVBMK-së), si dhe i pritshmërive të mbikëqyrësit për strukturën dhe përmbajtjen e raportit të këtij procesi, që duhet të paraqitet pranë Bankës së Shqipërisë. PVBMK-ja, e cila realizohet në mënyrë të pavarur nga banka, siguron vlerësimin e mjaftueshmërisë së niveleve aktuale dhe të ardhshme të kapitalit, bazuar në profilin e rrezikut dhe strategjitë e saj. Banka e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), realizon Procesin e Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (PRVM), bazuar në PVBMK-në e bankës, me qëllim formulimin e një gjykimi të përgjithshëm mbi profilin e rrezikut dhe të nevojave të saj për kapital.

1.2. Subjektet

Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat e licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

1.3. Baza juridike

Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
b) nenit 57, pika 1, 2, 4, 5 dhe nenit 59 pika 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe
c) kreut IX të rregullores nr. 48 datë 31.07.2013 "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", e ndryshuar.

1.4. Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat dhe në rregulloren për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe në rregulloren për kapitalin rregullator të bankës.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) *"kërkesa e brendshme për kapital"* - është shuma e kapitalit të brendshëm, që banka vlerëson të nevojshëm për të mbuluar/monitoruar humbjet, që tejkalojnë një nivel të pritshëm të një rreziku të caktuar;
b) *"kërkesa totale e brendshme për kapital"* - është shuma e kapitalit të brendshëm, që banka vlerëson të nevojshëm për të mbuluar/monitoruar të gjitha rreziqet materiale me të cilat përballet;
c) *"normë e synuar e kapitalit"* - është norma e vendosur në procesin e planifikimit të kapitalit;

d) *"stress-testing"* – është teknikë e administrimit të rreziqeve, e përdorur për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit të mundshëm të një ose më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, mbi qëndrueshmërinë financiare të bankës.

2. Procesi i Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVBMK)

2.1. Objektivi dhe parimet bazë të hartimit të PVBMK-së

Objektivi kryesor i PVBMK-së është krijimi i profilit të rrezikut të bankës dhe identifikimi i hershëm i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që mund të përkeqësojnë performancën e saj. Bankat në realizimin e këtij procesi duhet të ndjekin dy hapa: *hapi i parë:* të përcaktojnë nivelin e një rreziku specifik që mund të ndërmarrin, me qëllim përcaktimin e kapacitetit të tyre rrezik-mbajtës dhe sigurimin e kapitalit të mjaftueshëm për të mbuluar këtë rrezik, dhe *hapi i dytë:* të bëjnë një analizë kritike të nivelit të rrezikut që është e arsyeshme të ndërmerret, duke konsideruar të gjitha mundësitë dhe kërcënimet që i korrespondojnë këtij rreziku.

PVBMK-ja është një proces i mbështetur tërësisht mbi proceset dhe sistemet e brendshme të bankave, që ndihmojnë për administrimin dhe kontrollin me efektivitet të profilit të rrezikut dhe rrjedhimisht në përcaktimin e nivelit të nevojshëm të kapitalit. Ky proces është i orientuar drejt *elementeve sasiore* të procesit të administrimit të rrezikut - vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital dhe të kapitalit për mbulimin e rrezikut, si dhe të *elementeve cilësore* të tij, të krijuara për të forcuar rregullat e brendshme të drejtimit dhe kontrollit të bankës, të cilat mundësojnë administrimin efektiv dhe zbutjen e këtij rreziku.

Bankat sigurojnë një raport të përshtatshëm midis elementeve sasiore dhe cilësore[1], raporte të cilat nënkuptojnë që kapitali në vetvete nuk mund të zëvendësojë ose plotësojë në asnjë rast mangësitë e bankës në administrimin dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.

Bankat, në hartimin e PVBMK-së, duhet të konsiderojnë minimalisht zbatimin e parimeve bazë të mëposhtme:

a) ***Parimi i përgjegjësisë.*** Zbatimi dhe zhvillimi i PVBMK-së është përgjegjësi e bankës. Banka, në dialogun me mbikëqyrësit, siguron argumente të hollësishme lidhur me procedurat, metodologjitë dhe sistemet e përdorura për këtë proces;
b) ***Parimi i proporcionalitetit.*** Bankat janë të detyruara të zbatojnë PVBMK-në pavarësisht madhësisë dhe kompleksitetit të tyre. Në këtë kuadër, është përgjegjësi e bankës të vlerësojë mjaftueshmërinë e metodave, proceseve dhe sistemeve të PVBMK-së, në varësi kjo të natyrës, nivelit të rrezikut dhe kompleksitetit apo vëllimit të aktivitetit/veprimtarisë së saj. Bankat më të vogla, mund të përmbushin kërkesat e PVBMK-së, duke përdorur metoda të thjeshta. Bankat, të cilat kryejnë veprimtari komplekse ose transaksione me vëllim të lartë, mund të jetë e nevojshme të përdorin sisteme komplekse, me qëllim përmbushjen e kërkesave të PVBMK-së. Çdo bankë përdor mjetet dhe proceset e përshtatshme në PVBKM-në e saj, ndërsa është e detyruar të

[1] Raporti ndërmjet kërkesave të brendshme për kapital dhe efektivitetit dhe transparencës së proceseve të administrimit të rrezikut.

provojë/argumentojë për Bankën e Shqipërisë, se PVBMK-ja është e plotë dhe e përshtatshme për rreziqet që lindin nga veprimtaria dhe mjedisi ku ushtrohet kjo veprimtari;

c) ***Parimi i rëndësisë (materialitetit) të rreziqeve.*** PVBMK-ja është e bazuar/fokusuar në rreziqet, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm (material) mbi gjendjen aktuale ose të ardhshme të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës. Kërkesat e brendshme për kapital të bankës duhet të konsiderojnë profilin e saj të rrezikut dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm në mjedisin ku ajo vepron;

d) ***Parimi i perspektivës (looking forward).*** PVBMK-ja fokusohet në sigurimin e kapitalit të mjaftueshëm të bankës, duke konsideruar zhvillimet e ardhshme dhe ecurinë e veprimtarisë së saj. PVBMK-ja duhet të konsiderojë në veçanti ndikimin e ciklit të biznesit, faktorët e jashtëm që mund të kenë ndikim negativ në mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës, si edhe planet strategjike e lidhjen e tyre me faktorët makroekonomikë, për të cilët bankat harton dhe teston skenarët e mjaftueshëm në situata të jashtëzakonshme (*stress-test*-et).

Banka pasqyron rezultatet sasiore të PVBMK-së ose vlerësimet e ekspozimeve ndaj rreziqeve të rëndësishme, në kërkesën e brendshme për kapital dhe në vlerësimet e brendshme të kapitalit. Banka, në rastet kur identifikohen mangësi në sistemin e administrimit të rreziqeve ose në sistemin e kontrollit të brendshëm, mund të rrisë kërkesën e brendshme për kapital, si edhe të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të administrimit të rreziqeve, ose forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

2.2. Administrimi i dokumentacionit të PVBMK-së

Bankat hartojnë PVBMK-në në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, që do të ndihmonte punonjësit në kuptimin dhe zbatimin e procedurave të përcaktuara, si dhe do ta bënte më të lehtë për Bankën e Shqipërisë rishikimin dhe vlerësimin e mjaftueshmërisë së proceseve, të metodave dhe të sistemeve të bankës për këtë proces.

Bankat hartojnë një dokumentacion të shkruar mbi të gjithë elementet e PVBMK-së, i cili mund të mbështetet mbi dokumentacionin dhe përkufizimet ekzistuese që përputhen me kërkesat rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Bankat, në krijimin e dokumentacionit të kërkuar, sigurojnë që detajimi dhe qëllimi i shpjegimeve të tij, janë realizuar sipas nevojave të grupeve të synuar (*target groups*). Bankat përdorin nivele të ndryshme detajimi në zbatimin aktual të kërkesave të dokumentimit respektivisht për strategjitë, politikat, manualet dhe rregullat apo procedurat e brendshme.

Bankat sigurojnë që dokumentacioni të jetë i plotë dhe i përditësuar dhe kjo është një përgjegjësi me rëndësi në procesin e krijimit dhe mirëmbajtjes së tij. Bankat sigurojnë gjithashtu që dokumentet të jenë të shkruara dhe të ruajtura në mënyrë sistematike në letër, ose me një nga mjetet e qëndrueshme të komunikimit (e-mail, disketë, CD-ROM, DVD) dhe në një mënyrë që është e kuptueshme për palët e treta. Bankat nuk janë të detyruara të rishkruajnë të gjithë dokumentacionin e tyre, për qëllim të zbatimit të kërkesave të PVBMK-së, pasi dokumentacioni mund të bazohet në

udhëzimet dhe rregulloret ekzistuese. Megjithatë, bankat përditësojnë dokumentacionin me çdo përshtatje ose zgjerim të procesit të administrimit të brendshëm të rrezikut, që rezulton nga zbatimi i PVBMK-së, dhe në rast se është e nevojshme, në mënyrë sistematike bëjnë riorganizimin e këtij dokumentacioni.
Qëllimi dhe niveli i detajimit të dokumentacionit konsideron madhësinë, kompleksitetin dhe nivelet e rrezikut të bankës.

Një dokumentacion i strukturuar mirë do të kontribuonte në transparencën e procesit (PVBMK) të bankës, duke bërë të mundur që Këshilli Drejtues të vlerësojë më efektivisht hartimin e tij (PVBMK-së). Dokumentimi i plotë i të gjithë proceseve dhe rregullave të rëndësishme, paraqet rëndësi për të provuar mjaftueshmërinë e PVBMK-së së bankës për Bankën e Shqipërisë.

3. Kërkesa e brendshme për kapital

3.1 Të përgjithshme

Banka siguron nëpërmjet PVBMK-së një lidhje efektive midis profilit të rrezikut dhe nivelit e elementeve përbërës të kapitalit të nevojshëm, në baza individuale dhe të konsoliduara. PVBMK-ja i siguron bankës një balancim optimal midis kapitalit dhe ekspozimeve ndaj rreziqeve të rëndësishme (materiale) brenda kuadrit të këtij procesi (PVBMK), nëpërmjet sistemeve më efektive të administrimit të rreziqeve (proceseve të identifikimit, matjes/vlerësimit, monitorimit dhe kontrollit/zbutjes së rreziqeve). Planifikimi i kujdesshëm i kërkesës së brendshme për kapital, për periudhat aktuale dhe të ardhshme, i siguron bankës një stabilitet afatgjatë të kapacitetit të saj rrezik-mbajtës.

Banka, në llogaritjen e kërkesave të saj për kapital, konsideron të gjitha rreziqet e rëndësishme dhe faktorë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, që përcaktojnë profilin e saj të rrezikut. Banka krahason kërkesën e saj për kapital me vlerësimet e elementeve të kapitalit, me qëllim përcaktimin e kapitalit shtesë të nevojshëm për mbulimin/monitorimin e rreziqeve.

Kërkesa e brendshme për kapital, e llogaritur për qëllime të PVBMK-së, mund të jetë më e lartë ose më e ulët se kërkesa minimale për kapital. Disa nga arsyet mund të jenë si më poshtë:

a) **Përfshirja e rreziqeve dhe faktorëve** që nuk janë subjekt i kërkesave minimale për kapital dhe në këtë rast kërkesa e brendshme për kapital është më e lartë se kërkesa minimale për kapital;
b) **Përdorimi i teknikave të avancuara të matjes së rreziqeve, të tilla si modelet e brendshme për llogaritjen e kapitalit të bankës.** Në këtë rast, kërkesa e brendshme për kapital mund të jetë më e ulët se kërkesa minimale për kapital, por në çdo rast banka duhet të sigurojë nivelin e mjaftueshëm të kapitalit minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë;
c) **Marrja në konsideratë e efekteve të diversifikimit dhe ndërveprimit** të rreziqeve. Edhe në këtë rast, kjo mund të rezultojë në një kërkesë të brendshme për kapital më të ulët se kërkesa minimale për kapital, por në çdo rast banka duhet të sigurojë nivelin e mjaftueshëm të kapitalit minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë.

3.1.1 Rreziqet në PVBMK

Banka, në llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital, konsideron rreziqet dhe faktorët e mëposhtëm:

a) **Rreziqet të cilat janë subjekt i kërkesës minimale për kapital**. Banka, në llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional, përdor metodat e përcaktuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

b) **Rreziqet që nuk mbulohen tërësisht nga kërkesa minimale për kapital**. Banka, në llogaritjen e kërkesave të brendshme për kapital, konsideron edhe rreziqe që nuk mbulohen tërësisht nga kapitali minimal, i llogaritur sipas metodave standarde të parashikuara nga Banka e Shqipërisë (metoda standarde për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut ose metoda e treguesit të thjeshtë dhe ajo standarde për rrezikun operacional), të cilat në përgjithësi nuk marrin në konsideratë disa faktorë të veçantë në llogaritjen e kapitalit, për të mbuluar tërësisht një rrezik të caktuar. Për shembull, në rastin e rrezikut të kredisë, banka konsideron rrezikun e mbetur si rezultat i përdorimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë ose të pozicioneve në titullzime, ose në rastin e rrezikut operacional, konsideron rrezikun që rrjedh nga strategjia e planifikuar e veprimtarisë dhe rreziqet që rrjedhin nga objekti dhe kompleksiteti i veprimtarisë së saj, kur këto rreziqe përfshihen në përkufizimin e rrezikut operacional (shembuj tipik të këtyre rreziqeve paraqiten në **Aneksin 8** të këtij udhëzimi).

c) **Rreziqet që nuk janë subjekt i kërkesave minimale për kapital**. Banka, në llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital, përveç rreziqeve që janë subjekt i kërkesave minimale për kapital, konsideron edhe llogaritjen e nevojave të brendshme për kapital për rrezikun e normës së interesit në librat e bankës, rrezikun e përqendrimit, rrezikun reputacional, rrezikun e përfitueshmërisë, rrezikun strategjik etj. Banka, në varësi të kompleksitetit dhe veçorive të veprimtarisë së saj, mund të konsiderojë edhe rreziqe të tjera të kësaj kategorie dhe përdor metodat e saj të brendshme cilësore dhe sasiore për vlerësimin e tyre.

d) **Faktorë të mjedisit të jashtëm.** Banka, në llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital, konsideron edhe rreziqet që mund të materializohen në situata ekstreme, por jo të pamundura dhe me ndikim të konsiderueshëm në mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës. Këto rreziqe mund të rrjedhin nga faktorë të mjedisit makroekonomik ose të tregut, ose nga kuadri rregullativ, për vlerësimin e të cilave banka përdor *stress-test*-et.

3.1.2 *Stress Test*-et.

Banka, për qëllime të zbatimit të PVBMK-së, përdor *stress-test*-e, të cilat krijojnë një kuptim dhe pamje më të qartë të ekspozimeve të saj ndaj rreziqeve të ndryshme, dhe të vlerësimit të ndikimit të situatave ekstreme në një periudhë të caktuar, apo në disa periudha rresht ndaj të ardhurave dhe kapitalit të planifikuar. *Stress-test*-et bëjnë të mundur që banka të vlerësojë të gjitha rreziqet materiale në një mënyrë gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të orientuar nga e ardhmja dhe të realizojë

krahasimin e ndikimit të rezultateve nga *stress-test*-i me planin e veprimtarisë së saj dhe marrjen e masave të përshtatshme në kohën e duhur.

Bankat, veprimtaria e të cilave është jo e konsiderueshme dhe më pak komplekse, si dhe jo me rëndësi sistemike, mund të përmirësojnë vlerësimin e rrezikut, duke përdorur *stress-test*-e të thjeshta për qëllime të zbatimit të PVBMK-së. *Stress-test*-et e thjeshta, ose analizat e ndjeshmërisë, janë teknika jo të komplikuara për t'u zbatuar, sepse ato konsiderojnë vlerësimin e ndikimit të një ndryshimi në një faktor të vetëm rreziku (ngjarje *shock*) ndaj pozicionit financiar të bankës, pa përcaktuar shkakun e materializimit të situatës së pafavorshme (*shock*-ut). *Stress-test*-et e thjeshta, ose analizat e ndjeshmërisë, mund të përfshijnë për shembull vlerësimin e ndikimit të rënies së normave të interesit në ditë të veçanta në përfitueshmërinë e bankës, ose një vlerësim të ndikimit të përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredive në rritjen e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të kredisë, pa përcaktuar shkakun e ndodhjes së situatës.

Avantazhi kryesor i analizave të ndjeshmërisë është se, madhësia e rreziqeve/humbjeve për një faktor të veçantë, është lehtësisht e përcaktueshme (për shembull efekti që ka kursi i këmbimit dhe ngadalësimi i rritjes së PBB-së në probabilitetin e dështimit të individëve dhe bizneseve etj), ndërsa disavantazhi i saj është se shpesh dështon në paraqitjen e situatës së vërtetë të ekspozimit të bankës. Kjo shpjegohet me faktin që realisht (*de facto*), faktori i rrezikut i përdorur nuk vepron në mënyrë të izoluar, por i kombinuar me faktorë të tjerë.

Bankat e mëdha, me veprimtari më komplekse dhe me rëndësi sistemike, mund të përdorin analizat e ndjeshmërisë, por si rregull inkurajohen të përdorin teknika më komplekse ose të njohura si *stress-test*-e *skenari,* të cilat i japin mundësi bankës të përmirësojë parashikimet sipas modeleve të brendshme statistikore. *Stress-test*-et e bazuar në skenarë konsiderojnë vlerësimin e ndikimit të një ngjarjeje *shock* në një faktor të caktuar rreziku, apo një kombinim faktorësh rreziku, ku si bazë për përcaktimin e ndryshimit në faktorin e rrezikut mund të shërbejnë, ndër të tjera, ngjarjet historike ekstreme dhe të pafavorshme.

Këto analiza supozojnë ndryshimin e njëkohshëm të disa faktorëve të rrezikut dhe matin ndikimin e kombinuar në pozicionin e bankës, duke marrë në konsideratë edhe efekte dytësore dhe të vonuara në kohë. Këto analiza mund të bazohen gjithashtu në skenarë hipotetikë dhe historikë.

Avantazhi i kësaj analize është se merr në konsideratë ndërveprimin midis faktorëve të rrezikut, duke mundësuar trajtimin e rreziqeve të bankës në mënyrë të integruar. Në hartimin e analizave me skenarë, banka duhet të përdorë skenarë që janë në përputhje me profilin e rrezikut dhe kompleksitetin e saj, si dhe duhet të konsiderojë ndërveprimet dhe reagimet e parametrave.

Banka duhet të interpretojë dhe të kuptojë rezultatet e *stress-test*-eve të saj, në mënyrë që t'i shërbejnë si bazë në përcaktimin e qartë të masave për zbutjen e rrezikut. Drejtimi i lartë i bankës duhet të jetë i informuar dhe të marrë pjesë aktive në hartimin dhe mbikëqyrjen e programit të *stress-test*-it dhe në vlerësimin e rezultateve.

Stress-test-et duhet të përcaktohen duke marrë parasysh karakteristikat e portofolit të bankës dhe rreziqet e supozuara, në lidhje me mjedisin e jashtëm aktual. Banka, në rastet kur ndodh ndonjë ndryshim i këtyre faktorëve, rishikon testet e aplikuara, si dhe nëse nuk do të kishte ndryshime të faktorëve të sipërpërmendur, duhet të kryejë rishikime çdo vit.

Bankat më të mëdha inkurajohen të përdorin një kombinim të analizës së ndjeshmërisë dhe teknikave të analizës me skenar, ku metoda e fundit përfshin një interval më të gjerë të mbulimit të linjave të produktit/eve dhe zonave gjeografike.

Bankat duhet të integrojnë *stress–test*-et në mënyrë organike, në praktikat e administrimit të rrezikut, dhe rezultatet e tyre t'i përdorin për:

a) verifikimin e rezultateve të llogaritjes së kapitalit dhe vlerësimin e tyre në procesin e planifikimit (buxhetimit) të kapitalit;
b) vendimmarrjen e drejtimit të lartë (për shembull përpunimi i skenarëve të emergjencës, vendosja e kufijve etj);
c) llogaritjen e kapitalit rregullator shtesë pas dialogut me Bankën e Shqipërisë, dhe nëse është e nevojshme, për të marrë masa të mjaftueshme për zbutjen e rrezikut (rritja e kapitalit, strategjia, përdorimi i kufijve më prudentë etj.);
d) përpunimin e strategjisë së rrezikut;
e) vlerësimin e rezervave të likuiditetit.

3.1.3 Efekti i diversifikimit dhe ndërveprimit të rreziqeve

Banka, me qëllim llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital për të gjitha rreziqet, mund të marrë në konsideratë edhe efektet e diversifikimit dhe ndërveprimit të rreziqeve. Banka e Shqipërisë, duke konsideruar natyrën teknike dhe kompleksitetin e efekteve të diversifikimit ndërmjet rreziqeve dhe brenda grupit të rreziqeve individuale, si edhe në kushtet kur zhvillimi i modeleve ekonomike të brendshme të kapitalit bëhet në një fazë të hershme dhe në drejtime të ndryshme, nuk do të njohë këto efekte (në baza individuale dhe të konsoliduara) për një kërkesë të brendshme më të ulët për kapital.

3.1.4 Metodologjia për llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital

Banka, për llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional dhe për rreziqet e tjera (për shembull rrezikun e përqendrimit, etj), që nuk janë subjekt i kërkesave minimale për kapital, përdor metodat e parashikuara në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë[2] dhe/ose metodat apo modelet e saj të brendshme.

Bankat janë të inkurajuara të zhvillojnë modelet e tyre të brendshme për vlerësimin e rreziqeve të caktuara, ose për një pjesë të një rreziku të caktuar. Në këto raste, i gjithë informacioni i nevojshëm i kërkuar dhe argumentat përkatëse për mjaftueshmërinë e tyre, i paraqiten Bankës së Shqipërisë.

[2] Rregullorja për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe ky udhëzim.

3.2 Vlerësimi i kapitalit të brendshëm dhe norma e synuar e kapitalit

Banka përcakton elementet e kapitalit të brendshëm që do të konsiderohen për qëllime të zbatimit të PVBMK-së. **Banka e Shqipërisë, për qëllime të këtij udhëzimi, do të njohë si vlerësim të kapitalit të brendshëm kapitalin e llogaritur sipas rregullores për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë**, duke përfshirë treguesit e kapitalit dhe kufijtë për elementet përbërëse të tij.

Banka, në analizat dhe vlerësimin e kapacitetit të saj rrezik-mbajtës, siguron që kapitali total për mbulimin e rrezikut është gjithmonë i mjaftueshëm, për të mbuluar rreziqet e ndërmarra (kërkesa totale e brendshme për kapital).

Norma e synuar e kapitalit synon të konsiderojë një nivel të nevojshëm të kapitalit që duhet të mbahet si në të tashmen edhe në periudhat e ardhshme, sipas politikave dhe strategjisë së saj të biznesit.

Norma e synuar e kapitalit nuk është vetëm shumë e kërkesave për kapital të brendshëm, për mbulimin e rreziqeve ndaj të cilave banka është e ekspozuar, por duhet të konsiderojë edhe faktorët e mjedisit ku ushtron veprimtarinë. Sa më e lartë të jetë nevoja e evidentuar për kapital shtesë në PVBMK, ose sa më të mëdha të jenë mangësitë në drejtimin ose në administrimin apo kontrollin e rreziqeve të veçanta, aq më e lartë do të jetë rezerva përkundrejt kërkesës rregullative të Bankës së Shqipërisë për kapital.
Banka duhet të konsiderojë nëse paraqitet nevoja për një rezervë më të madhe të kapitalit, për shkak edhe të ushtrimit të veprimtarisë në një shtrirje të kufizuar gjeografike, apo në një fushë të veprimtarisë së saj.

Kjo normë vendoset nga vetë banka, brenda një kufiri të arsyeshëm luhatshmërie, bazuar në pritshmëritë e saj për të ardhmen. Banka duhet të sigurojë qëndrueshmërinë afatmesme dhe konsistencën e këtij objektivi, pavarësisht nga disekuilibrat e përkohshëm, që mund të lindin si pasojë e ndikimeve negative, ose rrethanave të veçanta.

Norma e synuar e kapitalit duhet gjithashtu t'i mundësojë bankës plotësimin e kërkesave për kapital, për qëllime të zbatimit të kërkesave rregullative të Bankës së Shqipërisë, edhe në rast të një rënieje të ndjeshme ekonomike, apo të rrethanave jo të favorshme të veprimtarisë, duke përdorur skenarë të përshtatshëm *stress-test*-i.

4. Zbatimi i procesit të Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (PRVM)

4.1 Të përgjithshme

PRVM-ja është pjesë integrale e procesit të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, i cili realizon rishikimin dhe vlerësimin e PVBMK-së, të ekspozimeve të bankës ndaj rrezikut dhe të përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në ligjin për bankat dhe në kuadrin rregullativ mbikëqyrës. Në kuadër të këtij procesi, Banka e Shqipërisë inkurajon një dialog aktiv me bankat, me qëllim identifikimin e menjëhershëm të mangësive të PVBMK-së dhe zbutjen e rrezikut, si dhe të sigurimit të niveleve të mjaftueshme të kapitalit.

Banka e Shqipërisë siguron që PRVM-ja të jetë konsistent dhe i bazuar në rregulla dhe procedura, të cilat përcaktojnë kërkesat për zbatimin e këtij procesi, bazuar në kritere të ndryshme për vlerësimin e mjaftueshmërisë së metodologjive, procedurave, sistemeve dhe llogaritjeve të realizuara në PVBMK, i cili duhet të konsiderojë dialogun me bankën gjatë realizimit të tij, krahasimin e rezultateve të PRVM-së midis bankave të ngjashme dhe krahasimin e profilit të rrezikut të një banke individuale gjatë periudhave të ndryshme, si dhe analizën e çdo rezultati të PRVM-së.

Banka e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), gjatë procesit të analizës së përgjithshme të profilit të rrezikut të bankës, sipas sistemit të vlerësimit të rrezikut, analizon çdo rezultat të PRVM-së dhe të raportit të saj (Bankës së Shqipërisë) për zbatimin e PVBMK-së dhe çdo informacion tjetër që rrjedh nga dialogu me bankën. Banka e Shqipërisë, analizon në mënyrë kritike mjaftueshmërinë e PVBMK-së për banka individuale dhe, në rastet që është e nevojshme, vendos dhe urdhëron ndërmarrjen e masave mbikëqyrëse.

4.2 Rishikimi dhe vlerësimi i PVBMK-së

Banka e Shqipërisë, si pjesë e procesit të saj mbikëqyrës, rishikon dhe vlerëson PVBMK-në, me qëllim sigurimin e niveleve të mjaftueshme të kapitalit, për të monitoruar rreziqet e ndërmarra nga banka dhe për përdorimin, zhvillimin dhe përmirësimin e metodave të administrimit të rrezikut. Banka e Shqipërisë, rishikon dhe vlerëson PVBMK-në, duke u bazuar përgjithësisht në raportin e PVBMK-së dhe në dialogun me bankën mbi mjaftueshmërinë e kapitalit.

4.2.1 Raporti i PVBMK-së

Raporti i PVBMK-së pasqyron aspektet sasiore dhe cilësore të procesit të PVBMK-së së bankës. Ky dokument bën të mundur njohjen me profilin e rrezikut të bankës dhe të rezultateve të metodologjive të përdorura për kërkesat e brendshme për kapital, të bazuar në rrezikun e ndërmarrë nga ajo (banka) dhe është një bazë për vendosjen e dialogut ndërmjet bankës dhe Bankës së Shqipërisë.

4.2.2 Dialogu midis Bankës së Shqipërisë dhe bankës

Banka e Shqipërisë, në procesin e dialogut me bankën, njihet me strategjinë e saj (bankës) në ndërmarrjen dhe administrimin e rreziqeve dhe të metodologjive të përdorura për vlerësimin/matjen e rreziqeve, krijimin e profilit të saj të rrezikut dhe llogaritjen e nevojave të brendshme për kapital (vlerësimi i agreguar i rreziqeve). Ky dialog është i strukturuar në mënyrë të tillë që fokuson elemente të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv të bankës, të strategjive të saj dhe të strukturës organizative, si dhe të metodës së përdorur për llogaritjen dhe plotësimin e nevojave të brendshme për kapital për mbulimin e rreziqeve të ndërmarra.

Intensiteti i këtij dialogu është në varësi të natyrës, objektit dhe kompleksitetit të veprimtarisë së bankës, si dhe të natyrës së rreziqeve ndaj të cilave është e ekspozuar. Banka, në procesin e dialogut për PVBMK-në, **duhet të paraqesë argumentet për Bankën e Shqipërisë lidhur me mjaftueshmërinë e këtij procesi.**

Banka e Shqipërisë dhe banka duhet të koordinojnë pozicionet lidhur me mjaftueshmërinë e PVBMK-së të bankës, brenda kuadrit të procesit të dialogut. Në rastet e mangësive në PVBMK, Banka e Shqipërisë dhe banka vlerësojnë zgjidhjet më të mira për korrigjimin e tyre. Banka duhet të shpjegojë natyrën e këtyre mangësive dhe shkakun e ndodhjes, si dhe duhet të përcaktojë afate për zgjidhjen ose përmirësimin e tyre. Çdo gjetje në elementet e PVBMK-së do të konsiderohet e plotësuar, vetëm pasi Banka e Shqipërisë pranon argumentet e bankës për zgjidhjen, ose përmirësimin e mangësive të identifikuara në PVBMK.

4.3 Masat mbikëqyrëse

1. Banka e Shqipërisë, në rastet kur nuk sigurohet zgjidhja apo përmirësimi i mangësive të PVBMK-së në procesin e dialogut me bankën, në bazë dhe për zbatim të dispozitave të ligjit për bankat dhe kuadrit rregullativ në fuqi, ndërmerr masat mbikëqyrëse të nevojshme. Masat mbikëqyrëse mund të përfshijnë, ndër të tjera, vendimet e Bankës së Shqipërisë respektivisht për:

a) reduktimin e ekspozimeve të bankës ndaj rreziqeve specifike (reduktim apo ndërprerje e disa veprimtarive), duke siguruar monitorimin e tyre me kapitalin e nevojshëm, dhe përmirësimin e profilit të saj të rrezikut; si dhe

b) kërkesa për nivele shtesë kapitali, me qëllim sigurimin e niveleve të mjaftueshme të kapitalit për mbulimin e rreziqeve specifike, të krijimit të sistemeve të duhura për administrimin e rrezikut etj. Kërkesa e Bankës së Shqipërisë për kapital shtesë pasqyron diferencën ndërmjet shumës së kapitalit të llogaritur nga banka, në procesin e PVBMK-së, dhe shumës së kapitalit të llogaritur nga Banka e Shqipërisë, në kuadrin e procesit PRVM.

2. Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të këtij udhëzimi, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

4.4 Vlerësimi i mjaftueshmërisë së PVBMK-së së bankës nga Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë jep vlerësimin mbi mjaftueshmërinë e PVBMK-së së bankës, bazuar në:

a) **Vlerësimin cilësor të PVBMK-së, sipas parimeve bazë që përdoren për hartimin e këtij procesi.** Banka e Shqipërisë, në rishikimin dhe vlerësimin e PVBMK-së, vlerëson nëse banka realizon procesin PVBMK, në përputhje me 10 parimet e tij, të cilat udhëzojnë bankën në zbatimin e këtij procesi (**Aneksi 6**);

b) **Vlerësimin sasior të PVBMK-së.** Banka e Shqipërisë vlerëson mjaftueshmërinë e kërkesave të brendshme për kapital dhe përshtatshmërinë e vlerësimit të kapitalit të brendshëm të bankës, mbi bazën e një krahasimi ndërmjet kërkesave të brendshme për kapital nga raporti i PVBMK-së dhe të vlerësimit të profilit të rrezikut të bankës, sipas sistemit të vlerësimit të rreziqeve. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse duhet të rishikohen (rriten) kërkesat e brendshme për kapital të bankës.

Banka e Shqipërisë, në vlerësimin sasior të PVBMK-së, vlerëson cilësinë e sistemeve të administrimit të rrezikut, që është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut sipas metodologjisë së vlerësimit të rreziqeve në fushën e organizimit, drejtimit dhe kontrollit të brendshëm dhe mundëson përcaktimin e kërkesave shtesë për kapital për rreziqe të veçanta. Një vlerësim i ulët/i dobët i cilësisë së sistemeve të administrimit të rrezikut, jo në çdo rast shoqërohet me rritje të kërkesës së brendshme për kapital shtesë, por është faktor i rëndësishëm i vlerësimit të Bankës së Shqipërisë, në përcaktimin apo ndërmarrjen e ndonjë mase mbikëqyrëse sipas dispozitave të ligjit për bankat.

Banka e Shqipërisë bën vlerësimin sasior të PVBMK-së çdo vit, pas paraqitjes nga banka të raportit të PVBMK-së dhe përpunimit të tij nga Departamenti i Mbikëqyrjes. Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën për gjetjet në procesin e vlerësimit të raportit të PVBMK-së dhe jep rekomandimet e përcakton afatet për plotësimin e rekomandimeve, lidhur me mangësitë e identifikuara gjatë procesit të vlerësimit të PVBMK-së.

5. Shënime shpjeguese për plotësimin dhe paraqitjen e raportit të PVBMK-së në Bankën e Shqipërisë

5.1 Të përgjithshme

Banka përgatit raportin e PVBMK-së me të dhënat sasiore dhe cilësore respektive, një herë në vit dhe në çdo rast që paraqiten ndryshime të rëndësishme në ekspozimin ndaj rreziqeve, me qëllim realizimin nga Banka e Shqipërisë të PRVM-së. Ky raport rishikohet dhe miratohet nga Këshilli Drejtues dhe i paraqitet Bankës së Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes) brenda datës 30 prill të çdo viti, me të dhënat e datës 31 dhjetor të periudhës së mëparshme.

Banka harton raportin e PVBMK-së, në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Kështu, detajimi i shpjegimeve dhe argumentimi i fushave apo çështjeve të veçanta në këtë raport, do të bëhet në varësi të rëndësisë së tyre (çështjeve apo fushave).

Raporti i PVBMK-së duhet t'i sigurojë përdoruesit një kuptim të qartë të të gjithë elementeve të tij. Raporti i PVBMK-së dhe përmbledhja e llogaritjeve të tij paraqiten në **Aneksin 1** të këtij udhëzimi, dhe përfshin elementet kryesore të mëposhtme:

SEKSIONI 1: Të dhënat bazë dhe përmbledhja ekzekutive;
SEKSIONI 2: Drejtimi i bankës;
SEKSIONI 3: Vlerësimi i rreziqeve dhe kërkesat e brendshme për kapital;
SEKSIONI 4: Planifikimi i kapitalit;
SEKSIONI 5: Plani i përmirësimit të PVBMK-së;
SEKSIONI 6: Aspekte/çështje të tjera.

5.2 Struktura e raportit të PVBMK-së

5.2.1 SEKSIONI 1: Të dhënat bazë dhe përmbledhja ekzekutive.

Në këtë seksion banka paraqet informacionin bazë për PVBMK-në dhe përmbledh shkurtimisht elementet më të rëndësishme. Banka shpjegon këtë informacion në formë më të detajuar në seksionet e tjera të raportit të PVBMK-së.

5.2.1.1 Të dhënat bazë.

Banka paraqet të dhënat e mëposhtme në raportin e PVBMK-së:

a) emrin e plotë, njësinë organizative dhe pozicionin e personit përgjegjës për hartimin e raportit të PVBMK-së ose personin përgjegjës për paraqitjen e informacionit pranë Bankës së Shqipërisë në lidhje me raportin e PVBMK-së;
b) numrat e kontaktit (telefon, faks, etj), adresë *email*-i;
c) të dhëna të ndryshme në lidhje me raportin e PVBMK-së (periudhën raportuese, datën e raportimit, datën e përditësimit të fundit, datën e rishikimit dhe miratimit nga Këshilli Drejtues);
d) firmën e personit përgjegjës për hartimin e raportit të PVBMK-së

5.2.1.2 Niveli i zbatimit të PVBMK-së

Banka harton raportin e PVBMK-së mbi baza individuale dhe/ose mbi baza të konsoliduara, në nivel grupi bankar. Banka, në rastet e zbatimit të PVBMK-së mbi baza të konsoliduara, paraqet një listë të institucioneve të varura të grupit bankar, të përfshira në raportin e PVBMK-së të bankës, siç përcaktohet në **Aneksin 4** të këtij udhëzimi.

Banka, në rastet kur institucionet e varura, vlerësohen se nuk zbatojnë PVBMK-në e duhur, ose paraqesin mangësi në të dhënat për llogaritjen mbi baza të konsoliduara të kërkesës së brendshme për kapital, duhet të paraqesë në mënyrë të përmbledhur masat dhe afatet për plotësimin e mangësive.

5.2.1.3 Profili i rrezikut të bankës

Banka paraqet një listë të rreziqeve me rëndësi materiale dhe kërkesat e brendshme për kapital për secilin rrezik, si dhe përmbledh analizën e profilit të rrezikut dhe gjetjet kryesore.

5.2.1.4 Drejtimi i bankës dhe sistemi i kontrollit të brendshëm

Banka përmbledh vetëvlerësimin e saj për mjaftueshmërinë e drejtimit të bankës dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me profilin e rrezikut, duke pasqyruar edhe mangësitë e evidentuara.

5.2.1.5 Norma e synuar e kapitalit *(Capital Target Ratio)* për mbulimin e rrezikut

Banka përcakton normën e synuar të kapitalit për të mbuluar plotësisht rrezikun, si në vlerë dhe në strukturë. Ky objektiv mund të përcaktohet në vlerë absolute ose në vlerë relative (përqindje), ndaj kërkesës së brendshme për kapital.

Banka krahason normën e synuar të kapitalit për mbulimin total të rrezikut, me raportin e kapitalit total ndaj rreziqeve të bankës në datën e raportimit.
Banka, në rastet kur është bankë mbizotëruese në një grup bankar, paraqet politikën e shpërndarjes së kapitalit të brendshëm në nivel grupi në lidhje me rreziqet materiale individuale, ndaj të cilave janë aktualisht ose mund të jenë të ekspozuara institucionet e varura të grupit, si dhe normën e synuar të kapitalit. Banka mbizotëruese, në hartimin e politikës së shpërndarjes së kapitalit në nivel grupi, konsideron mundësitë që ekzistojnë brenda grupit për këtë qëllim (nëpërmjet dividendit apo rritjeve të kapitalit)

Banka duhet të shpjegojë nëse ka marrë në konsideratë ndonjë vlerësim të jashtëm të cilësisë së kredisë, në përcaktimin e normës së synuar të kapitalit, për mbulimin e përgjithshëm të rrezikut, vlerësimi i cilit institucion të vlerësimit të jashtëm të kredisë është përdorur, si dhe objektivat për të marrë vlerësime të cilësisë së kredisë në të ardhmen.

5.2.1.6 Planifikimi i kapitalit

Banka përmbledh procesin e planifikimit të kapitalit për tre vitet e ardhshme, duke përfshirë politikën e saj për shpërndarjen e dividendëve, ose rritjet/shtesat (injektimet e reja) e kapitalit.

5.2.1.7 Plani i përmirësimi të PVBMK-së

Banka, në rastet kur është e nevojshme, paraqet në mënyrë të përmbledhur ndonjë pengesë apo dhe mangësi të PVBMK-së, si dhe paraqet masat kryesore dhe planin për korrigjimin e tyre në kohë.

5.2.1.8 Aspekte/çështje të tjera

Banka paraqet në mënyrë të përmbledhur gjetje të tjera të rëndësishme të papërfshira në seksionet e mëparshme, duke dhënë edhe konkluzionet përkatëse.

5.2.2 SEKSIONI 2: Drejtimi i bankës

Në këtë seksion banka paraqet një shpjegim të detajuar të strukturës së brendshme organizative, të procesit të administrimit të rrezikut dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm. Banka, në rastin kur është bankë mbizotëruese në një grup bankar, paraqet edhe ndryshimet/diferencat më të rëndësishme që evidentohen në PVBMK, si rezultat i pozicionit të institucioneve të varura më të rëndësishme të grupit.

5.2.2.1 Struktura Organizative

5.2.2.1.1 Përshkrimi i strukturës organizative të bankës

Banka paraqet skemën organizative të saj, si dhe përbërjen, pozicionin dhe përgjegjësitë respektive të Këshillit Drejtues, komiteteve dhe të Drejtuesve Ekzekutivë, në **Aneksin 5** të raportit të PVBMK-së. Në skemën organizative duhet të paraqiten edhe linjat e raportimit në procesin e administrimit të rrezikut.

5.2.2.1.2 Roli i Këshillit Drejtues të bankës në administrimin e rrezikut, mjedisin e kontrollit dhe mjaftueshmërinë e kapitalit

Në këtë pjesë banka shpjegon përgjegjësitë e marra nga Këshilli Drejtues i bankës lidhur me:

a) natyrën dhe madhësinë e rreziqeve të ndërmarra nga banka; si dhe
b) raportin e mjaftueshëm të kapitalit të brendshëm për monitorimin e këtyre rreziqeve.

Banka shpjegon se si Këshilli Drejtues krijon një kulturë të administrimit të rrezikut në bankë, e cila siguron që:

a) sofistikimi i proceseve të administrimit të rrezikut konsideron natyrën, qëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë që banka kryen;
b) sistemi i kontrollit të brendshëm siguron administrimin dhe zbutjen e mjaftueshme të rreziqeve;
c) kapitali i brendshëm i bankës për mbulimin e rreziqeve është i mjaftueshëm, në lidhje me profilin e rrezikut të saj dhe mjedisin makroekonomik në të cilin ajo vepron.

Banka përfshin në këtë pjesë edhe një listë të aktiviteteve më të rëndësishme të Këshillit Drejtues, në fushën e administrimit të rrezikut, në vitin e mëparshëm (periudha raportuese).

5.2.2.1.3 Vetëvlerësimi i strukturës organizative

Banka paraqet një vetëvlerësim të mjaftueshmërisë së strukturës së saj organizative, duke përfshirë edhe mangësitë e kësaj strukture (në rastet kur këto paraqiten).
Banka, në këtë proces vetëvlerësimi duhet të konsiderojë, ndër të tjera, edhe shkallën e përputhshmërisë me kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë, mbi parimet bazë të drejtimit dhe kërkesat për sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe duhet të cilësojë ndonjë dobësi ose mangësi të evidentuar.

Banka paraqet në këtë pjesë të raportit rezultatet e vetëvlerësimit.

5.2.2.2 Procesi i administrimit të rrezikut

5.2.2.2.1 Parimet e administrimit të rrezikut

Banka përmbledh parimet më të rëndësishme të administrimit të rrezikut, përcakton nivelin drejtues që përshtat parimet, si dhe paraqet një listë të dokumenteve (politikave) që përshtasin/konsiderojnë këto parime.

Banka përshkruan se cila strukturë/njësi organizative (apo person/a) siguron që njësitë organizative janë njohur me politikat për ndërmarrjen dhe administrimin e rrezikut, mënyra se si këto politika u komunikohen niveleve të ndryshme, duke siguruar që punonjësit të kuptojnë drejt objektivat e administrimit të rrezikut dhe se si kryhet ky proces.

Kjo pjesë duhet të përmbajë përshkrimin e funksioneve dhe përgjegjësive në procesin e administrimit të rrezikut, si dhe integrimin e tyre në skemën organizative të bankës.

5.2.2.2.2 Administrimi i rreziqeve individuale

Banka paraqet, në këtë pjesë të raportit, një listë të rreziqeve materiale të rëndësishme që përfshihen në PVBMK, si dhe për çdo rrezik, shpjegon:

a) Politikën e administrimit të rrezikut nga pikëpamja e kufijve të veçantë korrespondues dhe/ose teknikave të tjera të përdorura për zbutjen e tij. Banka vlerëson se si merren në konsideratë aktualisht politikat në procesin e vendimmarrjes, në fushën e administrimit të rrezikut.
b) Funksionin organizativ të administrimit të rrezikut nga pikëpamja e vlerësimit dhe matjes, monitorimit dhe administrimit të tij (rrezikut). Banka shpjegon ndarjen e përgjegjësive në fushën e administrimit të rrezikut, si dhe në rastet që ekziston një departament për administrimin e një rreziku specifik, shpjegon strukturën organizative të tij.
c) Proceset e administrimit të rrezikut individual (identifikimi, vlerësimi/matja, monitorimi dhe administrimi) nga pikëpamja e metodologjive, procedurave dhe sistemeve mbështetëse të teknologjisë dhe informacionit (TI). Banka, në rastet që disponon një bazë të dhënash në shërbim të administrimit të rrezikut, duhet të përshkruajë përdorimin dhe funksionimin e saj. Banka paraqet një listë të raporteve standarde dhe të veçanta për personelin e administrimit të rrezikut.

Në **Aneksin** 7 të këtij udhëzimi paraqitet një kategorizim sistematik i rreziqeve me qëllim përfshirjen ose mospërfshirjen e tyre në PVBMK, si dhe i metodës së vlerësimit të përdorur, sipas kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë apo metodës së brendshme, ndërkohë që banka duhet të formalizojë apo të dokumentojë formalisht vendimmarrjen për këtë qëllim (zgjedhjen e metodës së përdorur).

5.2.2.2.3 Vetëvlerësimi i procesit të administrimit të rrezikut.

Banka, për çdo rrezik të trajtuar në PVBMK, paraqet një vetëvlerësim të mjaftueshmërisë së politikave, të drejtimit (për shembull të strukturës organizative, delegimit të funksioneve, aktiviteteve e komiteteve të rrezikut), metodat e

vlerësimit/matjes dhe sistemet dhe procedurat korresponduese të kontrollit të brendshëm.

5.2.2.3 Sistemi i kontrollit të brendshëm

5.2.2.3.1 Detyrat e njësisë së kontrollit të brendshëm në procesin e administrimit të rrezikut

Banka paraqet një listë të fushave të kontrollit periodik, nga njësia e kontrollit të brendshëm në lidhje me administrimin e rrezikut në vitin e mëparshëm (periudha raportuese). Banka, në rastet kur është e përshtatshme, përmbledh konkluzionet më të rëndësishme të këtyre kontrolleve, të tilla si:

a) përputhshmëria me rregullat e brendshme (për shembull kontrolli i zbatimit të kufijve dhe procedurave);
b) përdorimi efektiv i rezultateve të PVBMK-së në vendimet e përditshme të drejtimit të bankës;
c) funksionimi efektiv dhe në nivele të kënaqshme i sistemit të kontrollit të brendshëm;
d) mjaftueshmëria e mbështetjes së sistemeve të teknologjisë dhe të informacionit (TI) për proceset e administrimit të rrezikut;
e) cilësia dhe integriteti i të dhënave të administrimit të rrezikut;
f) vlerësimi i mjaftueshmërisë së metodës së vlerësimit/matjes së rrezikut.

Banka, në rastet kur është e përshtatshme, paraqet një listë të masave që duhet të ndërmerren për të trajtuar mangësitë e identifikuara, si dhe përcakton pozicionet/strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre.

5.2.2.3.2 Vetëvlerësimi i funksionimit të njësisë së kontrollit të brendshëm

Banka paraqet një vetëvlerësim të njësisë së kontrollit të brendshëm mbi mjaftueshmërinë e kontrollit të proceseve dhe sistemeve të administrimit të rrezikut, si dhe të mjaftueshmërisë së burimeve të tij.

5.2.3 SEKSIONI 3: Vlerësimi i rreziqeve dhe kërkesave të brendshme për kapital

Në këtë seksion banka shpjegon aspektin sasior të PVBMK-së, vlerëson ekspozimin e saj ndaj rreziqeve individuale materialisht të rëndësishme dhe vlerëson kërkesën e brendshme totale për kapital.

5.2.3.1 Matja dhe vlerësimi i rreziqeve që janë subjekt i kërkesës minimale për kapital

Banka, në procesin e matjes dhe vlerësimit të ekspozimeve ndaj rreziqeve që janë subjekt i llogaritjes së kërkesës minimale për kapital respektivisht për rrezikun e kredisë, rreziqet e tregut dhe rrezikun operacional, përdor metodat standarde të parashikuara në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë.

5.2.3.1.1 Rreziku i kredisë

Banka, në vlerësimin e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë, paraqet në raportin e PVBMK-së një analizë të detajuar lidhur me rrezikun e kredisë, dhe në veçanti nëse ajo (banka) është e ekspozuar ndaj rreziqeve materialisht të rëndësishme, të cilat nuk janë mbuluar tërësisht nga kërkesa minimale për kapital. Sipas metodës standarde për rrezikun e kredisë, banka mund të përdorë një numër të konsiderueshëm teknikash për mbrojtjen e financuar të kredisë apo mbrojtjen e pafinancuar të saj, të tilla si kolateralet financiare, netimin, garancitë apo edhe derivativët e kredisë. Përdorimi i teknikave të zbutjes është subjekt i plotësueshmërisë së disa kërkesave cilësore, mosrespektimi i duhur i të cilave mund ta ekspozojë bankën ndaj rrezikut të mbetur *(residual risk)*. Po kështu, rritja e mundshme e ekspozimit si rezultat i pozicioneve në titullzime, të shkaktuar kryesisht nga transferimi i konsiderueshëm dhe efektiv i këtij rreziku ndaj palëve të treta dhe mungesa e një mbështetjeje jo të parashikuar qartë *(implicite)* në programe të ndryshme titullzimi të zbatuara nga vetë banka, mund të jetë një rrezik tjetër, i cili nuk mbulohet nga kërkesa minimale për kapital.

Banka duhet të përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress test*-it të përdorur dhe në rastet kur rezulton që kapitali i kërkuar për rrezikun e kredisë duhet të rregullohet (korrigjohet) me rezultatet e *stress-test*–it për këtë rrezik, duhet të shpjegojë *stress-teste*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi *(stress-testing)*.

5.2.3.1.2 Rreziqet e tregut

Banka, në vlerësimin e kërkesës për kapital për rreziqet e tregut, paraqet në raportin e PVBMK-së, një analizë të detajuar të të gjitha ekspozimeve të rëndësishme ndaj rreziqeve të tregut dhe që nuk janë të mbuluara nga kërkesa minimale për kapital për rreziqet e tregut.

Bankat, të cilat nuk llogarisin kërkesë për kapital për rreziqet e tregut, duhet të plotësojnë këtë pjesë të raportit të PVBMK-së, vetëm nëse vlerësojnë që rreziqet e tregut ndaj të cilave ato ekspozohen, janë materialisht të konsiderueshme. Kështu, rastet për t'u marrë në konsideratë nga banka mund të jenë situatat e mëposhtme:

a) kur madhësia e portofolit të tregtueshëm, edhe pse nuk është subjekt i kërkesës për kapital (nuk plotëson kufirin rregullativ), mund të vlerësohet nga banka me një ndikim potencial të konsiderueshëm në kapital, si rrjedhojë e luhatshmërisë së lartë të normave të interesit për një instrument ose grup instrumentesh financiare të borxhit në portofolin e tregtueshëm, për arsye të pritshmërive të tregut për rënie të konsiderueshme të çmimit dhe faktorizim të tyre, edhe pse renditja e emetuesit nuk ka ndryshuar sipas vlerësimit nga institucionet e jashtme të vlerësimit të kredisë, ose për rënie të konsiderueshme të çmimit për arsye të ndryshimit të shpejtë të renditjes së emetuesit;
b) kur madhësia e portofolit të tregtueshëm nuk është subjekt i kërkesës për kapital (nuk plotëson kufirin rregullativ), por banka zotëron një portofol të konsiderueshëm të vendosjes, i cili vlerësohet me vlerën e tregut dhe pavarësisht nëse ka ose jo ndikim të drejtpërdrejtë në kapital, humbjet e parealizuara mund të konvertohen në humbje të realizuara, në rast të një

pjese ose tërësisht të portofolit, do të klasifikohet në portofolin e tregtueshëm ose do të shitet potencialisht në treg.

Banka duhet të përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress test*-it të përdorur, dhe në rastet kur rezulton që kapitali i kërkuar për rreziqet e tregut duhet të rregullohet (korrigjohet) me rezultatet e *stress-test* –it për këto rreziqe, duhet të shpjegojë *stress-test*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi *(stress-testing)*.

5.2.3.1.3 Rreziku operacional

Banka, në vlerësimin e kërkesës për kapital për rrezikun operacional, paraqet në raportin e PVBMK-së, një analizë të detajuar të të gjitha ekspozimeve të rëndësishme ndaj rrezikut operacional dhe që nuk janë të mbuluara nga kërkesa minimale për kapital për rrezikun operacional. Banka, në vlerësimin sasior të ekspozimit ndaj rrezikut operacional, përdor metodën e treguesit të thjeshtë, metodën standarde dhe/ose metodën e treguesit alternativ për linja të caktuara biznesi.

Metoda e treguesit të thjeshtë përbën alternativën më të thjeshtë për këtë vlerësim dhe rekomandohet kryesisht për bankat e vogla, të cilat nuk kanë burime të mjaftueshme njerëzore, infrastrukturën e përshtatshme teknologjike për të zhvilluar dhe për të zbatuar metodologjinë për shpërndarjen e së ardhurës neto nga veprimtaria bankare sipas linjave të biznesit.

Metoda standarde dhe metoda e treguesit alternativ për linja të caktuara biznesi rekomandohet kryesisht për banka më të mëdha, të cilat janë kryesisht pjesë të grupeve të huaja bankare dhe/ose financiare, dhe si të tilla mund të kenë mbështetjen e bankave mëmë me ekspertizën e duhur, për të ndërtuar një proces më të strukturuar për vlerësimin e rrezikut operacional, apo që synojnë të zbatojnë standarde më të larta për arsye të monitorimit dhe vlerësimit të rrezikut operacional në mënyrë të unifikuar në nivel grupi. Megjithë këtë, për arsye dhe rrethana të caktuara mund të ndodhë që bankat, të cilat rekomandohet të zbatojnë metodën standarde, të zgjedhin për të vlerësuar rrezikun operacional sipas metodës se treguesit të thjeshtë dhe anasjelltas.

Në kushtet kur nuk vërtetohet një lidhje e rëndësishme ndërmjet ekspozimit ndaj rrezikut operacional dhe të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, si në rastin e metodës së treguesit të thjeshtë dhe të metodës standarde, si edhe me qëllim vlerësimin më të mirë të profilit të rrezikut, banka duhet të ndërtojë dhe të mbështetet në procese më sistematike, të cilat sigurojnë mbledhjen dhe organizimin e një baze të dhënash (historike) me humbjet nga rreziku operacional. Banka, në rastet që vlerëson se ekspozimi ndaj rrezikut operacional nuk mbulohet tërësisht nga metodat standarde (për shembull, rasti kur humbjet faktike të paparashikuara nga rreziku operacional janë më të mëdha se kapitali i llogaritur për këtë qëllim), mund të bëjë një rishikim të kërkesës për kapital për rrezikun operacional.

Banka duhet të përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress test*-it të përdorur dhe në rastet kur rezulton që kapitali i kërkuar për rrezikun operacional duhet të rregullohet (korrigjohet) me rezultatet e *stress-test* –it për këtë rrezik, duhet të shpjegojë *stress-teste*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi *(stress testing)*.

5.2.3.2 Matja dhe vlerësimi i rreziqeve që nuk janë subjekt i kërkesës minimale për kapital

5.2.3.2.1 Rreziku i përqendrimit

Banka, në vlerësimin e kërkesave të brendshme për kapital për rrezikun e përqendrimit të kredisë, paraqet në raportin e PVBMK-së një analizë të rrezikut të përqendrimit të kredisë, si rrezik që mund të gjenerojë humbje, të cilat mund të cënojnë seriozisht qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarisë së bankës. Disa nga format më të rëndësishme të rrezikut të përqendrimit të kredisë mund të paraqiten si më poshtë:

a) përqendrimi ndaj klientëve ose grupeve të lidhura të klientëve;
b) përqendrimi ndaj klientëve me probleme (banka për qëllime të PVBMK-së përcakton rrezikun maksimal që mund të ndërmarrë, për këtë kategori ekspozimesh);
c) përqendrimi ndaj një vendi të caktuar (në rastin e rrezikut të vendit, rreziku nga ekspozimi nuk vjen direkt nga paaftësia e kundërpartisë për të shlyer detyrimin, por nga zhvillimet ekonomike dhe politike në një vend, të cilat mund të kenë ndikim mbi pozicionin financiar të klientit të bankës dhe rrjedhimisht, rritja e ekspozimit ndaj një vendi të caktuar mund të shkaktojë humbje të konsiderueshme për bankën, nëse materializohet rreziku i vendit);
d) përqendrimi ndaj një industrie/sektori ekonomik, i cili rrjedh nga ekspozimi ndaj klientëve, pozicioni financiar i të cilëve varet nga produkte apo shërbime të njëjta;
e) përqendrimi ndaj ekspozimeve në monedhë të huaj dhe/ose të indeksuar në monedhë të huaj, që ndryshe njihet si rreziku indirekt me burim efektin negativ të kursit të këmbimit, i cili rrjedh nga kreditë e disbursuara në monedhë të huaj dhe/ose të indeksuara në monedhë të huaj, veçanërisht në rastet kur të ardhurat e huamarrësit gjenerohen në një monedhë të ndryshme nga monedha e disbursimit (kryesisht në monedhën vendase);
f) përqendrimi ndaj teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, i cili rrjedh nga përqendrime në përdorimin e konsiderueshëm të një lloj/tip kolaterali apo të një garantuesi të vetëm për një numër të konsiderueshëm kredish.

Banka, në vlerësimin e kërkesës së brendshme për kapital për këtë rrezik, referuar përqendrimit sipas sektorëve ekonomikë dhe sipas klientëve/grupeve të lidhura të klientëve, mund të përdorë metodën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë ose metodën e saj të brendshme, nëse ka një të tillë.

I) Metoda e Bankës së Shqipërisë

a) Llogaritja e përqendrimit sektorial sipas kësaj metode bazohet në Indeksin e *Herfindahl-Hirschman (HHI),* siç përcaktohet në **Aneksin 2** të këtij udhëzimi. Banka, në këtë llogaritje do të konsiderojë reduktimet dhe përjashtimet e parashikuara për llogaritjen e ekspozimeve të mëdha në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha. Banka, në rastin kur HHI-ja e tejkalon vlerën 10, duhet të rrisë vlerësimin e kërkesës së brendshme për kapital për rrezikun e përqendrimit sektorial, duke

shumëzuar kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë me vlerën përkatëse të rrezikut sipas përshkallëzimit që paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Indeksi i përqendrimit sektorial	Përshkallëzimi
0 < HHIs ≤ 10	0%
10 < HHIs ≤ 15	2%
15 < HHIs ≤ 20	4%
20 < HHIs ≤ 25	6%
25 < HHIs ≤ 100	8%

b) Llogaritja e përqendrimit sipas klientëve/grupeve të lidhura të klientëve bazohet në Indeksin e *Herfindahl-Hirschman (HHI)* siç përcaktohet në **Aneksin 2** të këtij udhëzimi. Banka, në këtë llogaritje do të konsiderojë reduktimet dhe përjashtimet e parashikuara për llogaritjen e ekspozimeve të mëdha në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha. Banka, në rastin kur HHI-ja e tejkalon vlerën vlerën 1, duhet të rrisë vlerësimin e kërkesës së brendshme për kapital për rrezikun e përqendrimit sipas klientëve/grupeve të lidhura të klientëve, duke shumëzuar kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë me vlerën përkatëse të rrezikut sipas përshkallëzimit që paraqitet në tabelën e mëposhtme:

c)

Indeksi i përqendrimit të klientëve/grupeve të lidhura të klientëve	Përshkallëzimi
0 < HHIi ≤ 1	0%
1 < HHIi ≤ 2	2%
2 < HHIi ≤ 4	4%
4 < HHIi ≤ 10	6%
10 < HHIi ≤ 100	8%

II) Metoda e Brendshme

Banka mund të përdorë metodën e saj të brendshme për llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital për rrezikun e përqendrimit (sipas sektorëve dhe sipas klientëve/grupeve të lidhura të klientëve) dhe duhet të argumentojë për Bankën e Shqipërisë që kjo metodë i përshtatet më mirë natyrës dhe nevojave të administrimit të këtij rreziku në bankë. Metodat e brendshme për këtë qëllim rekomandohen për bankat, të cilat disponojnë modele funksionale të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë për qëllime të brendshme.

Banka, në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e përqendrimit, në kuadrin e përgatitjes së raportit të PVBMK-së për Bankën e Shqipërisë, duhet të:

a) plotësojë **Aneksin 2** të këtij udhëzimi, në rast se përdor metodën e Bankës së Shqipërisë;
b) shpjegojë metodën e brendshme nga pikëpamja e supozimeve dhe arsyetimeve të përdorura, në rast se përdor metodën e brendshme;
c) argumentojë, në rast se banka nuk llogarit kërkesë të brendshme për kapital për rrezikun e përqendrimit;

d) përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress-test*-it të përdorur dhe në rastet kur kapitali i kërkuar për rrezikun e përqendrimit duhet të rregullohet (korrigjohet) me rezultatet e *stress-test*–it për këtë rrezik, të shpjegojë s*tress-teste*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi *(stress-testing)*.

5.2.3.2.2 Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

Banka, në vlerësimin e kërkesave të brendshme për kapital për rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, paraqet në raportin e PVBMK-së një analizë të ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të luhatjeve të normës së interesit në librin e bankës, i cili është në përgjithësi rreziku më i rëndësishëm i kategorisë së rreziqeve të tregut, për bankat të cilat nuk kanë ekspozim në portofolin e tregtueshëm.

Banka, në vlerësimin e kërkesës së brendshme për kapital për këtë rrezik, mund të përdorë metodën e përcaktuar në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës ose metodën e saj të brendshme, nëse ka një të tillë. Banka, në rastet ku përdor metodën e saj të brendshme, duhet të argumentojë për Bankën e Shqipërisë që kjo metodë i përshtatet më mirë natyrës dhe nevojave të administrimit të këtij rreziku në bankë dhe mund të përdorë një *shock* jouniform përgjatë kurbës së normave të kthimit dhe/ose një kufi maksimal të humbjes apo ekspozimit ndaj kapitalit të brendshëm.

Banka llogarit kërkesë për kapital për rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, në rast se humbja apo ekspozimi i llogaritur sipas metodës së Bankës së Shqipërisë apo metodës së brendshme, tejkalon kufirin prej 20% të kapitalit të brendshëm. Kërkesa për kapital llogaritet si prodhim i vlerës së tejkaluar mbi 20%, me kapitalin e brendshëm.

Banka, në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, në kuadrin e përgatitjes së raportit të PVBMK-së për Bankën e Shqipërisë, duhet të:

a) plotësojë **Aneksin 3** të këtij udhëzimi, në rast se përdor metodën e Bankës së Shqipërisë;
b) shpjegojë metodën e brendshme nga pikëpamja e supozimeve dhe arsyetimeve të përdorura, në rast se përdor metodën e brendshme;
c) përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress-test*-it të përdorur dhe në rastet kur kapitali i kërkuar për rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, duhet të rregullohet (korrigjohet) me rezultatet e *stress-test*–it për këtë rrezik, të shpjegojë *stress-test*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi *(stress-testing)*.

5.2.3.2.3 Rreziku i likuiditetit të tregut

Banka, në kuadër të zbatimit të PVBMK-së, vlerëson kërkesën e brendshme për kapital për rrezikun e likuiditetit të tregut, i cili rrjedh nga pamundësia e shitjes ose zëvendësimit të pozicioneve të një instrumenti në periudha afatshkurtra me një ndikim jo të konsiderueshëm në çmimin e tregut, ose per shkak të pamjaftueshmërisë së tregut *(insufficient market depth),* ose të çekuilibrave të tij *(market imbalances)*.

Banka, me qëllim sigurimin e plotësimit të kërkesave për kapital për rrezikun e likuiditetit të tregut, duhet të krijojë një ambient të përshtatshëm kontrolli për këtë rrezik, që përfshin zhvillimin dhe zbatimin e duhur në praktikë të politikave dhe rregulloreve të brendshme, përtej kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë.

Banka duhet minimalisht të përcaktojë dhe monitorojë kufij për administrimin e rrezikut të likuiditetit të tregut, të materializuar në *spread*-in ndërmjet çmimit të blerjes dhe shitjes së instrumenteve financiare likuide apo vëllimit të realizuar në treg.

Banka, në kuadrin e përgatitjes së raportit të PVBMK-së për këtë rrezik, duhet të paraqesë:

a) shpjegime mbi politikën dhe angazhimin në administrimin e rrezikut të likuiditetit të tregut, kontrollet e brendshme dhe planet për administrimin e situatave të krizës; si dhe
b) të përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress-test*-it të përdorur, dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi *(stress-testing)*.

5.2.3.2.4 Rreziqet e tjera

Banka, në vlerësimin e kërkesës së brendshme për kapital për rreziqet e tjera, konsideron minimalisht llojet/tipet e mëposhtme të rreziqeve, duke vlerësuar edhe materialitetin e tyre, respektivisht:

a) **Rrezikun strategjik**, si rrezik që rrjedh nga humbjet financiare, si rezultat i vendimmarrjes/ve strategjike të papërshtatshme apo jo të mirëstudiuara në veprimtarinë e bankës;
b) **Rreziku reputacional,** si rrezik që rrjedh nga humbjet financiare, si rezultat i rënies së reputacionit në veprimtarinë e subjektit/eve, për shkak të opinionit negativ të publikut ndaj bankës;
a) **Rreziku i kapitalit**, si rrezik që rrjedh nga struktura e brendshme e papërshtatshme e kapitalit në raport me natyrën dhe madhësinë e rreziqeve, ose nga vështirësitë e bankës për të gjeneruar kapital shtesë në kohën e duhur, nëse do të jetë e nevojshme;
b) **Rreziku i të ardhurave**, si rrezik që rrjedh nga diversifikimi i pamjaftueshëm i strukturës së të ardhurave të bankave, ose paaftësia për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të përfitueshmërisë në vazhdimësi.

Banka, në rastet kur nuk llogarit kërkesën e brendshme për kapital për rreziqet e tjera, duhet të paraqesë argumentet përkatëse në këtë pjesë të raportit të PVBMK-së.

Bankat, për shkak të mungesës së metodave sasiore të vlerësimit të rreziqeve të tjera, mund të vlerësojnë këtë kategori rreziqesh në mënyrë cilësore. Në këtë rast, banka duhet të argumentojë vlerësimin cilësor të këtyre rreziqeve dhe të dokumentojë në mënyrën e duhur, si dhe të analizojë arsyet e humbjeve përtej atyre të parashikuara nga kjo kategori rreziqesh (nëse ka të tilla), në mënyrë që të marrë masat e duhura për monitorimin e tyre në të ardhmen. Kjo bëhet duke u mbështetur në një kuadër rregullash të brendshme të vetë bankës, të cilat përfshijnë metodat dhe proceset që sigurojnë parandalimin apo reduktimin e materializimit të rreziqeve të tjera.

Banka, në rastet kur llogarit kërkesën e brendshme për kapital për rreziqet e tjera, mund të korrigjojë këtë kërkesë me vlerësimin cilësor të këtyre rreziqeve. Banka mund të përdorë metodën e Bankës së Shqipërisë ose metodën e saj të brendshme për llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital për rreziqet e tjera.

I) Metoda e Bankës së Shqipërisë

Banka që përdor metodën e Bankës së Shqipërisë mund të rrisë kërkesën e brendshme për kapital nga 5% deri në 15 % të kërkesave minimale për kapital. Banka duhet të argumentojë dhe të paraqesë shpjegime të mjaftueshme, në këtë pjesë të raportit të PVBMK-së, për nivelin (%) e përdorur në bazë të ekspozimit aktual apo të ardhshëm.

II) Metoda e brendshme

Banka mund të përdorë metodën e saj të brendshme për llogaritjen e kërkesës së brendshme për kapital për rreziqet e tjera dhe duhet të argumentojë për Bankën e Shqipërisë, që kjo metodë i përshtatet më mirë natyrës dhe nevojave të administrimit të kësaj kategorie rreziqesh në bankë.

Banka, në llogaritjen e kërkesës për kapital për rreziqet e tjera, në kuadrin e përgatitjes së raportit të PVBMK-së për Bankën e Shqipërisë, duhet të:

a) shpjegojë dhe specifikojë përqindjen e aplikuar për kapital shtesë, në rast se përdor metodën e Bankës së Shqipërisë;
b) shpjegojë metodën e brendshme nga pikëpamja e supozimeve dhe arsyetimeve të përdorura, në rast se përdor metodën e brendshme;
c) argumentojë, në rast se banka nuk llogarit kërkesë të brendshme për kapital për rrezikun e përqendrimit;
d) përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress-test*-it të përdorur dhe në rastet kur kapitali i kërkuar për këto rreziqe duhet të rregullohet (korrigjohet) me rezultatet e *stress-test* –it për këtë rrezik, të shpjegojë *stress-test*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi (*stress-testing).*

5.2.3.2.5 Faktorët e mjedisit të jashtëm dhe *stress-test*-et

Banka, në vlerësimin e kërkesës së brendshme për kapital, gjatë procesit të PVBMK-së, konsideron edhe rreziqet që rrjedhin nga faktorë të mjedisit të jashtëm bazuar në *stress test*-et e ndryshme. Banka mund të përcaktojë elemente (rezerva) të kapitalit të saj të brendshëm për mbulimin e këtyre rreziqeve, me qëllim përdorimin e tyre në situata krize.

Banka, në rastet kur përdor *stress-test*-et për vlerësimin e rreziqeve, që mund të rrjedhin nga faktorë të mjedisit makroekonomik ose të tregut ose nga kuadri rregullativ, duhet të shpjegojë në këtë pjesë të raportit të PVBMK-së *stress-test*-et e aplikuara, si dhe rezultatet dhe dokumentet e brendshme, që i korrespondojnë këtij procesi *(stress-testing).*

5.2.3.2.6 Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital të bazuar në rrezik

Banka llogarit kërkesën e brendshme totale për kapital, bazuar në vlerësimet individuale të nevojave për kapital për rreziqe të ndryshme, siç përcaktohet në seksionet e këtij udhëzimi, si shumë të kërkesave për kapital të llogaritur për rreziqet individuale.
Banka paraqet kërkesën totale për kapital në raportin e PVBMK-së për Bankën e Shqipërisë, sipas **Aneksit 1** të këtij udhëzimi.

5.2.4 SEKSIONI 4: Planifikimi i kapitalit

Banka, në këtë seksion të raportit të PVBMK-së përcakton projektimet dhe analizat në fushën e planifikimit të kapitalit. Banka, në procesin e planifikimit të nivelit të synuar të kapitalit të brendshëm, duhet të marrë në konsideratë planin strategjik të rritjes së veprimtarisë, politikën e dividendit, ndryshimet e projektuara në profilin e rrezikut, rezultatet e PVBMK-së etj.

Banka, në raportin e PVBMK-së për Bankën e Shqipërisë, duhet:

a) të pasqyrojë periudhën e planifikimit të kapitalit, e cila nuk duhet të jetë më e shkurtër se tre vjet;
b) të analizojë diferencat ndërmjet kapitalit të planifikuar për periudhën në fjalë dhe kapitalit të llogaritur në periudhën e mëparshme;
c) të shpjegojë metodologjinë e planifikimit të kapitalit, duke paraqitur rezultatet e saj;
d) të shpjegojë *stress–test*-et dhe rezultatet e tyre, duke iu referuar dokumenteve korresponduese të brendshme; dhe
e) të përshkruajë dhe shpjegojë kuadrin e brendshëm të *stress-test*-eve të përdorura dhe rezultatet e dokumentet e brendshme që i korrespondojnë këtij procesi (*stress- testing),* si dhe në rastet kur është e aplikueshme:
    i. të referojë burimet alternative të kapitalit për të plotësuar nevojën për kapital në të ardhmen; dhe
    ii. të shpjegojë planin e emergjencës *(contingency plan)* në rast se kërkesa e brendshme për kapital e projektuar është më e madhe se kapitali që parashikohet të sigurohet nga burimet e ndryshme alternative.

5.2.5 SEKSIONI 5: Plani i përmirësimit të PVBMK-së

Banka, në këtë seksion të raportit të PVBMK-së, paraqet masat dhe veprimet që ka ndërmarrë për të korrigjuar mangësitë në procesin PVBMK, ose për ta përmirësuar atë.
Banka, duke u mbështetur në vetëvlerësimet e elementeve individuale të drejtimit të saj dhe të ekspozimeve ndaj rreziqeve materiale, shpjegon mangësitë dhe dobësitë më të mëdha në këtë proces (PVBMK) dhe vendos një plan të veprimeve për t'i korrigjuar ose përmirësuar ato.

Plani i veprimeve mund të përcaktojë masa:

a) për të përmirësuar profilin e rrezikut të bankës, si: zvogëlimi i disa aktiviteteve, përdorimi i një mbrojtjeje të re ndaj rrezikut të kredisë etj;
b) për të përmirësuar drejtimin dhe organizimin e brendshëm të bankës, si: përmirësimi i proceseve të administrimit të rrezikut, forcimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

Banka paraqet edhe çdo ndryshim të planifikuar në lidhje me politikën e administrimit të kapitalit ose të administrimit të rrezikut. Shembuj të këtyre ndryshimeve përfshijnë përmirësimet në:

a) metodat e llogaritjes së kërkesave minimale për kapital;
b) metodologjinë për vlerësimin e kërkesave të brendshme për kapital;
c) teknikat e administrimit të rreziqeve individuale;
d) sistemin e brendshëm të kontrollit për administrimin/zbutjen e rreziqeve.

5.2.6 SEKSIONI 6: Aspekte/çështje të tjera të PVBMK-së

Banka, në këtë seksion të raportit të PVBMK-së, paraqet të gjitha gjetjet dhe rezultatet e tjera të këtij procesi, të patrajtuara në seksionet e tjera.

ANEKSI 1: Raporti i PVBMK-së dhe formulari përmbledhës i llogaritjeve

RAPORTIMI NË BANKËN E SHQIPËRISË MBI ZBATIMIN E PVBMK-së
[Emri i bankës]

1. TË DHËNAT BAZË DHE PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Të dhënat bazë

Periudha e vlefshmërisë:	d	d	m	m	v	v	v	v	–	d	d	m	m	v	v	v	v

(periudha së cilës i referohet raportimi PVBMK)

Emri i plotë:		Data e raportimit PVBMK:	d	d	m	m	v	v	v	v

(personi përgjegjës për komunikimin me Bankën e Shqipërisë)

(data e raportimit të fundit në Bankën e Shqipërisë)

Pozicioni:		Përditësimi i fundit:	d	d	m	m	v	v	v	v

(data e përditësimt të fundit në raportimin e PVBMK-së)

Njësia organizative:		Tregues ndryshimesh:	

(tregim i pjesëve të raportimit të cilat janë ndryshuar/përditësuar))

Këshilli Drejtues		Rishikuar/miratuar	d	d	m	m	v	v	v	v

(data e rishikimit të fundit të raportimit të PVBMK-së nga Këshilli Drejtues)

	Emri dhe kodi i dokumentit:	

(i referohet dokumentit që konfirmon rishikimin dhe miratimin e raportimit të PVBMK-së nga Këshilli Drejtues)

Nënshkrimi i personit përgjegjës për plotësimin e raportimit të PVBMK-së :_____

1.2 Niveli i zbatimit të PVBMK-së [Shënim: Një bankë mbizotëruese që zbaton PVBMK-në mbi baza të konsoliduara duhet të paraqesë një listë të institucioneve të varura të përfshira në PVBMK në Aneksin 4 të raportit të PVBMK-së]
1.3 Profili i rrezikut të bankës
1.4 Drejtimi i bankës dhe sistemi i kontrollit të brendshëm
1.5 Norma e synuar e kapitalit të bankës
1.6 Planifikimi i kapitalit
1.7 Plani i përmirësimit të PVBMK-së
1.8 Aspekte/çështje të tjera.

2. DREJTIMI I BANKËS
2.1 Struktura organizative
[Skema e strukturës organizative të bankës] (Shënim: Të paraqitet në Aneksin 5 të raportit të PVBMK-së)
[Roli i Këshillit Drejtues të bankës në administrimin e rrezikut, mjedisin e kontrollit dhe mjaftueshmërinë e kapitalit]
[Vetëvlerësimi i strukturës organizative]

2.2 Procesi i administrimit të rrezikut
[Parimet e administrimit të rrezikut]
[Administrimi i rreziqeve individuale] (Shënim: Sqarimet duhet të jepen për çdo rrezik)
[Vetëvlerësimi i procesit të administrimit të rreziqeve individuale] (Shënim: Sqarimet duhet të jepen sipas së njëjtës radhë të rreziqeve)
2.3 Sistemi i kontrollit të brendshëm
[Detyrat e njësisë së kontrollit të brendshëm në procesin e administrimit të rrezikut]
[Vetëvlerësimi i funksionimit të njësisë së kontrollit të brendshëm]

3. VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE KËRKESAVE TË BRENDSHME PËR KAPITAL

3.1 Matja dhe vlerësimi i rrezikut të kredisë

Metoda e përdorur: [1] [2] (përzgjidh)	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Për bankat që përdorin metodën e Bankës së Shqipërisë:		
[Analiza e ekspozimit ndaj rreziqeve individuale, që nuk janë të mbuluara mjaftueshëm nga kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë (d.m.th. mjaftueshmëria e përdorimit të mbrojtjes së kredisë dhe rrezikut korrespondues të mbetur, analizë e rreziqeve që rrjedhin nga programet e titullzimit)].		
[Aty ku duhet, të tregohet vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital për secilin nga rreziqet (vlerësim sasior)].		
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korrespondues dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese].		
Për bankat që përdorin metodën e brendshme:		

[Sqarim dhe argumentime për metodologjinë e përdorur dhe për supozimet e saj.]
[Analizë e çdo diference ndërmjet kërkesave për kapital për rrezikun e kredisë dhe vlerësimin e kërkesave të brendshme për kapital për rrezikun e kredisë.]
[Referencë/a për dokumente të brendshme, mbi të cilat bazohet metodologjia e përdorur].
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese].

3.2 Matja dhe vlerësimi i rreziqeve të tregut

Metoda e përdorur: [1] [2] (përzgjidh)	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Për bankat që përdorin metodën e Bankës së Shqipërisë:		
[Analizë e të gjitha ekspozimeve materiale ndaj rrezikut të tregut që nuk janë të mbuluara nga kërkesa për kapital për rreziqet e tregut]		
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]		
Për bankat që përdorin metodën e brendshme:		
[Shpjegim dhe argumentim për metodologjinë e përdorur dhe supozimet e saj]		
[Analizë e diferencave ndërmjet kërkesave për kapital për rreziqet e tregut dhe vlerësimit të kërkesave të brendshme për kapital për rreziqet e tregut] [Referencë/a për dokumente të brendshme, mbi të cilat bazohet metodologjia e përdorur]		
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]		

3.3 Matja dhe vlerësimi i rrezikut operacional

Metoda e përdorur: [1] [2] (përzgjidh)	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Për bankat që përdorin metodën e Bankës së Shqipërisë:		
[Analizë e të gjitha ekspozimeve materiale ndaj rrezikut operacional që nuk janë të mbuluara nga kërkesa për kapital për rrezikun operacional]		
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]		
Për bankat që përdorin metodën e brendshme:		
[Shpjegim dhe argumentim për metodologjinë e përdorur dhe supozimet e saj]		
[Analizë e diferencave ndërmjet kërkesave për kapital për rrezikun operacional dhe vlerësimit të kërkesave të brendshme për kapital për rrezikun operacional] [Referencë/a për dokumente të brendshme, mbi të cilat bazohet metodologjia e përdorur]		
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]		

3.4 Matja dhe vlerësimi i rrezikut të përqendrimit

Metoda e Bankës së Shqipërisë: [PO] [JO]	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Metoda e brendshme: [PO] [JO] (përzgjidh)	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Për bankat që përdorin metodën e Bankës së Shqipërisë:		

[Të plotësohet Aneksi 2] ose [Të jepen argumente që për bankën nuk është e nevojshme të kryejë një vlerësim të kërkesave të brendshme për kapital]
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]
Për bankat që përdorin metodën e brendshme:
[Shpjegim dhe argumentim për metodologjinë e përdorur dhe supozimet e saj.]
[Referencë/a për dokumente të brendshme, mbi të cilat bazohet metodologjia e përdorur.]
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]

3.5 Matja dhe vlerësimi i rrezikut të normës së interesit në librin e bankës

Metoda e Bankës së Shqipërisë: [PO] [JO]	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Metoda e brendshme: [PO] [JO] (përzgjidh)	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Për bankat që përdorin metodën e Bankës së Shqipërisë:		
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]		
Për bankat që përdorin metodën e brendshme:		
[Shpjegim dhe argumentim për metodologjinë e përdorur dhe supozimet e saj.]		

[Referencë/a për dokumente të brendshme, mbi të cilat bazohet metodologjia e përdorur.]
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korrespondues.]

3.6 Matja dhe vlerësimi i rrezikut të likuiditetit të tregut

Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital:	[vendos këtu]
Për të gjitha bankat:	
[Shpjegim dhe argumentim për politikat e ndërmarrjes dhe administrimit të rrezikut të likuiditetit të tregut, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe planet e krizave]	
[Referencë/a për dokumente të brendshme korrespondues]	
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korresponduese dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese.]	

3.7 Matja dhe vlerësimi i rreziqeve të tjera materiale

Metoda e Bankës së Shqipërisë: [PO] **Metoda e brendshme: [PO] [JO]**	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital**	[vendos këtu]
Për bankat që përdorin metodën e Bankës së Shqipërisë:		
[Rritja e vlerësimit të kërkesave të brendshme për kapital me një përqindje të kërkesave minimale për kapital (të vendoset përqindja)]: **[5% - 15%]**		
[Shpjegim dhe argumentim për përqindjen e përdorur]		
Për bankat që përdorin metodën e brendshme:		
[Shpjegim dhe argumentim për metodologjitë e përdorura për të vlerësuar rreziqet e		

tjera materiale (sipas rendit)]
[Referencë/a për dokumente të brendshme, mbi të cilat bazohet metodologjia e përdorur]
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et, duke cituar rezultatet korrespondues dhe duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshëm korrespondues.]

3.8 Faktorët e mjedisit të jashtëm dhe *stress-test*-et

Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital	[vendos këtu]
Për të gjitha bankat	
[Shpjegimi i *stress-test*-eve dhe citimi i rezultateve korresponduese]	
[Aty ku duhet, të jepet një vlerësim i rrezikut rregullator që rrjedh nga pamundësia e bankës për të siguruar plotësimin e kërkesave të kuadrit rregullativ në fuqi]	
[Referencë/a për dokumente të brendshme korresponduese, në lidhje me *stress-test*-et]	

3.9 Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital të bazuar në rrezik

Metoda e përdorur:	**Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital:**	**Efektet e diversifikimit (të evidentuara vetëm për qëllime të brendshme):**	**Vlerësimi i përgjithshëm i kërkesave të brendshme për kapital:**
[vendos këtu]	(a) [vendos këtu]	(b) [vendos këtu, nëse ka]	(a) + (b) [vendos këtu]
Për të gjitha bankat:			
[Plotësimi i formularit përmbledhës të llogaritjeve të raportit të PVBMK-së në këtë aneks]			

4. Planifikimi i kapitalit

Periudha e planifikimit të kapitalit:	[vendos këtu]
Për të gjitha bankat :	
[Analizë e diferencave ndërmjet normës së synuar të kapitalit në periudhën në fjalë dhe kapitalit të brendshëm në periudhën e mëparshme]	
[Shpjegim i metodologjisë dhe rezultateve të planifikimit të kapitalit, dhe referenca për dokumente të brendshme korresponduese]	
[Aty ku duhet, të shpjegohen *stress-test*-et dhe rezultatet, duke dhënë referenca të dokumenteve të brendshme korresponduese. Aty ku duhet, të përmenden burime alternative të kapitalit të brendshëm.]	

5. Plani i përmirësimit të PVBMK-së

[Shpjegim i dobësive dhe mungesave kryesore, të identifikuara nga banka përmes PVBMK-së]
[Aty ku duhet, të jepen referenca të dokumenteve të brendshme, që mbulojnë planin e masave, me qëllim korrigjimin apo përmirësimin e PVBMK-së në të ardhmen]
[Listë e ndryshimeve të planifikuara apo të projektuara në strategjinë e administrimit të rrezikut]

6. Aspekte/çështje të tjera.

(51) [Aty ku duhet, të shpjegohen elemente të tjera të PVBMK-së, që nuk mbulohen nga ky raportim i PVBMK-së.]

FORMULAR PËRMBLEDHËS I LLOGARITJEVE NË RAPORTIN E PVBMK-SË

Emri i Bankës		Data	

I. NORMA DHE TREGUESIT E SYNUAR TË KAPITALIT TË BANKËS	
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (në%)	
Kapitali bazë i nivelit të parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun (në %)	
Kapitali i nivelit të parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun (në %)	

II. KAPITALI I BRENDSHËM I BANKËS DHE VLERËSIMET E BRENDSHME TË KAPITALIT	
Kapitali i brendshëm i bankës:	
Kapitali bazë i nivelit të parë:	
Kapitali shtesë i nivelit të parë:	
Kapitali i nivelit të dytë:	
Zëra të përfshirë ne vlerësimet e brendshme të kapitalit (+ ose -) Të gjithë zërat:	
……	
……	
…..	
…..	
Vlerësime totale të brendshme të kapitalit	

III. KËRKESAT MINIMALE PËR KAPITAL DHE VLERËSIMI I KËRKESAVE TË BRENDSHME PËR KAPITAL					
		SHTYLLA I		SHTYLLA II (PVBMK)	
		Metoda e llogaritjes së kërkesave minimale për kapital	Kërkesat minimale për kapital (në milionë lekë)	Metoda e vlerësimit të kërkesave të brendshme për kapital	Vlerësimi i kërkesave të brendshme për kapital (në milionë lekë)
A) Elementi 1: Rreziqet subjekt i kërkesave minimale për kapital					
Rreziku i kredisë					
Rreziku i tregut					
Rreziku operacional					
B) Elementi 2: Rreziqet jo tërësisht të mbuluara nga kërkesat minimale për kapital					
Rreziku i kredisë (i mbetur)					
Rreziku i tregut					
Rreziku operacional					
C) Elementi 3: Rreziqet që nuk janë subjekt i kërkesave minimale për kapital					
Rreziku i përqëndrimit					
Rreziku i normës së interesit në librin e bankës					
Rreziku i likuiditetit të tregut					
Rreziqe të tjera					
nga të cilët:	a) Rreziku strategjik				
	b) Rreziku reputacional				
	c) Rreziku i kapitalit				
	d) Rreziku i të Ardhurave				
	e) etj (të vendoset nga banka, nëse duhet)				
D) Elementi 4: Faktorë të mjedisit të jashtëm					
Stress-testet					
Kërkesa totale e brendshme për kapital					
E) Efektet e diversifikimit (-) (vetëm për qëllime të brendshme)					
nga të cilët:	a) Për të njëjtin rrezik				
	b) Për rreziqe të ndryshme				
F) Vlerësimi total i kërkesave të brendshme për kapital dhe efektet e diversifikimit (vetëm për nevoja të brendshme)					

IV. PLANIFIKIMI I KAPITALIT				
(në milionë lekë)	Aktuale	Projeksioni		
	Viti aktual (t)	Viti t+1	Viti t+2	Viti t+3
Ekspozimet e Ponderuara me Rrezikun	"A"			
Kapitali Rregullator	"B"			
Kërkesa Minimale për Kapital (Shtylla I)	"C"			
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	"B"/"A"			
Kërkesa për Kapital (Shtylla II)	"D"			
Kërkesa Totale për Kapital (përfshi strategjinë dhe ndryshimin e kushteve të biznesit)	"E" = "C" + "D"			
Strategjia e biznesit (e materializuar ne buxhet) dhe rreziqet që burojnë prej saj	%E			
Ndryshimi i kushteve të biznesit, e materializuar sipas skenareve të Stres testeve	%E			
Kërkesa shtesë për kapital	"F" = "E" - "B"			
Burimet/mjaftueshmëria e financimit të kërkesës shtesë për kapital				

ANEKSI 2: Rreziku i përqendrimit

A) Përqendrimi sektorial

Banka llogarit ekspozimin e përgjithshëm të një sektori sipas tabelës së mëposhtme. Indeksi i përqendrimit sektorial (HHIs) llogaritet në bazë të formulës së mëposhtme:
HHIs = ∑ x2 / (∑x)2 * (∑x) / y, ku x i referohet vlerës së ekspozimit të një sektori specifik dhe y i referohet vlerës së ekspozimit total.
Banka klasifikon ekspozimet e saj sipas sektorëve në përputhje me të dhënat në dispozicion.

Degët e ekonomisë		
SEKTORI (bazuar ne KSAE*)	EKSPOZIMI TOTAL NDAJ SEKTORIT	%
1. Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura		
2. Peshkimi		
3. Industria nxjerrëse		
4. Industria përpunuese		
5. Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit		
6. Ndërtimi		
7. Tregtia, Riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake		
8. Hotelet dhe restorantet		
9. Transporti, Magazinimi dhe Telekomunikacioni		
10. Ndërmjetësim monetar dhe financiar		
11. Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, etj.		
12. Administrimi publik		
13. Arsimi		
14. Shëndeti dhe veprimtaritë sociale		
15. Shërbime kolektive, sociale dhe individuale		
16. Të tjera		

** Klasifimi Standard i Aktiviteteve ekonomike (versioni kombëtar i NACE)*

B) Përqendrimi individual

Banka përllogarit ekspozimin e përgjithshëm ndaj 100 kredimarrësve më të mëdhenj pavarësisht statusit të tyre. Indeksi i përqendrimit individual (HHII) llogaritet në bazë të formulës së mëposhtme:
HHII = ∑ xi2 / (∑xi)2 * ∑ xi / ∑y * 100; ku "xi" i referohet vlerës së "i" klientëve në portofolin e bankës (sipas ekspozimit total), "y" i referohet vlerës totale të portofolit të bankës, dhe "i" i referohet numrit të klientëve të konsideruar në përllogaritjen e HHI (i = 100).

	EKSPOZIMI TOTAL	% EKSPOZIMIT
Ekspozimi total	∑ y	100
100 kredimarrësit më të mëdhenj	∑ x	
Indeksi i përqendrimit individual		HHII

ANEKSI 3: Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes sipas metodës së vlerësimit të ndryshimit të ekspozimit të librit të bankës, shpërndajnë pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit, në 14 intervale kohore, siç përcaktohet në tabelën e këtij aneksi.
2. Bankat shpërndajnë pozicionet me normë interesi fikse në intervale kohore, sipas maturitetit të mbetur, dhe pozicionet me normë interesi të ndryshueshme në intervale kohore, sipas kohës, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit.
3. Bankat përdorin peshat e ponderuara të përcaktuara në tabelën e këtij aneksi, të cilat llogariten si prodhim i *shock*-ut të normës së interesit prej 200 pikësh bazë (ose 2%) me kohëzgjatjen e modifikuar *(estimated modified duration)* për çdo interval kohor.
4. Bankat, në rastet kur përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, ndjekin hapat e mëposhtëm:
   a. mbledhin, për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara, pozicionet e aktiveve dhe pasiveve dhe instrumenteve financiare derivative (ose zërat e aktiveve dhe pasiveve jashtë bilancit), për secilin interval kohor, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto për çdo interval;
   b. shumëzojnë pozicionin total neto të llogaritur sipas shkronjës "a" të këtij paragrafi, për çdo interval kohor, me peshat e përcaktuara në tabelën e këtij aneksi, për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;
   c. mbledhin të gjitha pozicionet e ponderuara, të llogaritura për të gjitha intervalet kohore, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto në blerje *(long)* ose në shitje *(short)* për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;
   d. mbledhin pozicionet neto në blerje *(long)* dhe në shitje *(short)* për të gjitha monedhat, me qëllim llogaritjen e pozicionit total neto të ponderuar në librin e bankës.
5. Pozicioni total neto i ponderuar në librin e bankës, që përcaktohet në shkronjën "d" të pikës 4 të këtij aneksi, shprehet në vlerë/shumë absolute dhe do të përfaqësojë ndryshimin në ekspozimin e librit të bankës, si rezultat i aplikimit të *shock*-ut standard të normës së interesit.
6. Bankat llogarisin raportin e ndryshimit të ekspozimit në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në përqindje.

Peshat e ponderimit sipas intervaleve kohore *(time band)*				
Intervali kohor	**Mesi i intervalit kohor**	**Kohëzgjatja e modifikuar**	**Ndryshimi i parashikuar në kthim/përfitim *(yield)***	**Peshat e ponderimit**
(1)	(2)	(3)	(4)	(5) = (3)*(4)
menjëherë (*at sight*)	0	0	200 bp	0.00%
Deri në 1 muaj	0.5 muaj	0.04 vite	200 bp	0.08%
1 - 3 muaj	2 muaj	0.16 vite	200 bp	0.32%
3 - 6 muaj	4.5 muaj	0.36 vite	200 bp	0.72%
6 - 12 muaj	9 muaj	0.71 vite	200 bp	1.43%
1 - 2 vite	1.5 vite	1.38 vite	200 bp	2.77%
2 - 3 vite	2.5 vite	2.25 vite	200 bp	4.49%
3 - 4 vite	3.5 vite	3.07 vite	200 bp	6.14%
4 - 5 vite	4.5 vite	3.85 vite	200 bp	7.71%
5 - 7 vite	6 vite	5.08 vite	200 bp	10.15%
7 - 10 vite	8.5 vite	6.63 vite	200 bp	13.26%
10 - 15 vite	12.5 vite	8.92 vite	200 bp	17.84%
15 - 20 vite	17.5 vite	11.21 vite	200 bp	22.43%
Mbi 20 vite	22.5 vite	13.01 vite	200 bp	26.03%

ANEKSI 4: Lista e institucioneve të varura të grupit bankar dhe/ose financiar të përfshira në PVBMK (niveli i zbatimit të PVBMK-së).

Në këtë aneks paraqitet lista e institucioneve të varura, pjesë të grupit bankar, të cilat përfshihen në PVBMK të bankës (mbizotëruese), në rastet që është e aplikueshme.

ANEKSI 5: Skema organizative e bankës, përbërja, pozicioni dhe përgjegjësitë respektive të nivelit drejtues (Këshilli Drejtues dhe Drejtuesit Ekzekutivë) dhe të komiteteve.

Në këtë aneks paraqitet skema organizative e bankës, si dhe përbërja, pozicioni dhe përgjegjësitë respektive të nivelit drejtues (Këshillit Drejtues dhe Drejtuesve Ekzekutivë) dhe të komiteteve.

ANEKSI 6: Parimet e PVBMK-së

Në këtë aneks paraqiten parimet e përgjithshme të PVBMK-së të përpunuara sipas rekomandimeve të EBA-s. Parimet duhet të shërbejnë si një udhëzim për të gjitha bankat për hartimin e PVBMK-së së tyre.

PVBMK 1: Çdo bankë duhet të ketë një proces për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas profilit të saj të rrezikut.

Çdo bankë duhet të ketë drejtim efektiv dhe procedura të administrimit të rrezikut të mjaftueshme, duke përfshirë një strategji dhe procese që kanë për qëllim arritjen dhe mbajtjen e një niveli kapitali që është i mjaftueshëm për natyrën e aktiviteteve dhe rreziqeve të bankës. *Përmbushja e këtij parimi mund të ekzaminohet në nivel grupi dhe në nivel individual (shiko më poshtë).*

PVBMK 2: PVBMK është përgjegjësi për bankën

- Çdo bankë është përgjegjëse për PVBMK-në e saj, dhe për vendosjen e objektivave të brendshme të kapitalit që janë në përputhje me profilin e rrezikut të bankës dhe mjedisin ku ushtron veprimtarinë;
- PVBMK duhet të hartohet sipas nevojave dhe rrethanave të bankës dhe duhet të përdorë *input*-e dhe përcaktime që banka i përdor normalisht për qëllime të brendshme;
- PVBMK duhet të përmbushë kërkesat mbikëqyrëse dhe banka duhet të jetë e aftë për ta provuar këtë;

PVBMK 3: Hartimi i PVBMK-së duhet të specifikohet plotësisht, politika e administrimit dhe planifikimit të kapitalit të bankës duhet dokumentuar plotësisht dhe organet drejtuese duhet të marrin përgjegjësi për PVBMK-në.

- Përgjegjësia për fillimin dhe dizenjimin e PVBMK mbetet tek Këshilli Drejtues, i cili miraton parimisht qëllimin, metodologjinë e përgjithshme dhe objektivat e PVBMK-së, ndërsa detajet dhe konceptet teknike janë përgjegjësi e Drejtuesve Ekzekutivë;
- Këshilli Drejtues është përgjegjës edhe për integrimin e planifikimit të kapitalit dhe menaxhimit të tij, në kulturën dhe qasjen ndaj administrimit të rrezikut të bankës;
- PVBMK i bankës (psh. Metodologjitë, supozimet dhe procedurat) dhe politika e kapitalit duhet të dokumentohen formalisht, dhe duhet të rishikohen dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i bankës;
- Rezultatet e PVBMK-së duhet t'i raportohen Këshillit Drejtues të bankës.

PVBMK 4: PVBMK-ja duhet të jetë pjesë integrale e procesit të drejtimit dhe kulturës vendimarrëse të bankës.

PVBMK-ja duhet të jetë pjesë integrale e proceseve drejtuese të bankës me qëllim që t'i mundësojë Këshillit Drejtues të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme rreziqet që vijnë nga aktivitetet dhe janë materiale për bankën.

PVBMK 5: Duke qenë se PVBMK-ja bazohet tek proceset dhe procedurat, përshtatshmëria e zbatueshmërisë së tij duhet të rishikohet rregullisht, të paktën një herë në vit.

- Një PVBMK duhet të rishikohet nga banka sa herë që është e nevojshme (por të paktën një herë në vit) për të siguruar që rreziqet janë të mbuluara mjaftueshëm dhe që mbulimi me kapital të pasqyrojë profilin aktual të rrezikut të bankës;
- PVBMK dhe procesi i rishikimit të tij duhet të jenë subjekt i një rishikimi të pavarur të brendshëm;

- Çdo ndryshim në fokusin strategjik të bankës, planit të biznesit, mjedisit operues ose faktorëve të tjerë që ndikojnë materialisht supozimet ose metodologjitë e përdorura në PVBMK, duhet të nxisë korrigjimet e duhura. Rreziqet e reja që shoqërojnë veprimtarinë e bankës duhet të identifikohen dhe të përfshihen në PVBMK.

PVBMK 6: PVBMK-ja duhet të jetë i bazuar në rrezik

Mjaftueshmëria e kapitalit të një banke është një funksion i profilit të saj të rrezikut. Bankat duhet të vendosin objektiva kapitali të cilat të jenë në përputhje me profilin e rrezikut dhe mjedisin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Bankat mund të marrin në konsideratë edhe faktorë të tjerë për vendimin se sa kapital duhet të mbajnë, si psh vlerësimet e jashtme të rrezikut të kredisë, reputacionin e tregut dhe objektivat strategjikë.

Banka duhet të vendosë qartë për cilat rreziqe është e domosdoshme nje matje sasiore dhe për cilat rreziqe janë të rëndësishëm faktorët cilësorë; në rastin e dytë theksi duhet të vihet ne administrimin e rrezikut dhe përdorimin e instrumenteve të zbutjes së rrezikut.

Edhe bankat të cilat aplikojnë metoda më të thjeshta për të matur rrezikun e kredisë, të tregut dhe rrezikun operacional, janë të detyruara që të bazojnë PVBMK-në e tyre dhe të sigurojnë adresimin e rreziqeve aktuale.

PVBMK 7: PVBMK-ja duhet të jetë gjithëpërfshirëse

- Në PVBMK, banka duhet të trajtojë të gjitha rreziqet materiale ndaj të cilave është e ekspozuar megjithëse nuk ekziston një kategorizim standard i llojeve të rrezikut dhe përkufizim mbi materialitetin;
- Banka është e lirë të përdorë terminologjinë dhe përkufizimet e saj. Banka e Shqipërisë kërkon që banka të jetë e aftë të prezantojë në detaje qasjet dhe terminologjinë dhe përkufizimet që ajo aplikon në PVBMK (së bashku me diferencat në krahasim me metodat e llogaritjes së kapitalit rregullator) gjatë dialogut ndërmjet bankës dhe Bankës së Shqipërisë;
- PVBMK-ja duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe duhet të marrë në konsideratë të gjitha rreziqet materiale.

PVBMK 8: PVBMK-ja duhet të fokusohet nga e ardhmja/perspektiva

- PVBMK duhet të marrë në konsideratë planet strategjike të bankës dhe se si ato lidhen me faktorët ekonomikë. Banka duhet të zhvillojë një strategji të brendshme për të mirëmbajtur nivelet e kapitalit, të cilat mund të përfshijnë faktorë të tillë si rritja e pritshme e huamarrjes, burimet e mundshme të rritjes së kapitalit në të ardhmen, politika e dividendit, si dhe çdo efekt prociklik;
- Banka duhet të ketë një plan të nevojave për kapital të miratuar, i cili duhet të deklarojë objektivat e bankës dhe periudhën kohore për arritjen e këtyre objektivave, dhe në trema të përgjithshme, procesin e planifikimit të kapitalit dhe specifikimin e personave që janë përgjegjës për këtë proces. Plani duhet të tregojë se si banka do të trajtojë situatat, të cilat kërkojnë veprim të menjëhershëm (psh. rritja e kapitalit shtesë, kufizimi i veprimtarisë ose përdorimi i teknikave të zbutjes së rrezikut).

PVBMK 9: PVBMK-ja duhet të bazohet në procese vlerësimi dhe matjeje të përshtatshme

- PVBMK-ja duhet të bazohet në matje dhe vlerësime të përshtatshme të rreziqeve, por nuk ekziston një metodë e vetme korrektuese e PVBMK-së. Duke qenë se bankat janë të lira të zgjedhin metodën që ato dëshirojnë të aplikojnë, autoriteti mbikëqyrës konsideron disa qasje të pranueshme dhe që jo

domosdoshmërisht kërkojnë përdorimin e modeleve komplekse të llogaritjes së kapitalit. Pavarësisht kësaj, bazuar në parimin e proporcionalitetit, mbikëqyrësi kërkon që bankat, të cilat ushtrojnë aktivitete komplekse dhe të ndryshme të aplikojnë teknika sasiore të avancuara në linjë me sistemin e tyre specifik;

- Disa elemente të rrezikut, si dhe kërkesat përkatëse për kapital mund të jenë të vështira për t'u llogaritur, por autoriteti mbikëqyrës kërkon që shifrat e kapitalit për këto rreziqe të përcaktohen nga vlerësimet e ekspertëve;
- Është e rëndësishme që bankat të mos mbështeten vetëm tek metodat sasiore në procesin e PVBMK-së, por të konsiderojnë vlerësime cilësore dhe prudente të administrimit të rrezikut lidhur me *inputet* dhe *outputet* e modelit.

PVBMK 10: PVBMK-ja duhet të prodhojë një rezultat të arsyeshëm.

PVBMK-ja, pasi është identifikuar kërkesa për kapital për llojet specifike të rreziqeve, duhet të evidentojë kërkesën totale të brendshme për kapital të bankës. Kjo shifër duhet të jetë e arsyeshme, psh. ajo duhet të jetë në proporcion me rreziqet aktuale të bankës dhe duhet të jetë bashkërenduar me nivelin e kapitalit rregullator. PVBMK-ja duhet të rezultojë në një shifër të kërkesës totale për kapital të brendshëm dhe një vlerësim që e mbështet atë. Procedura e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të prodhojë një rezultat të përgjithshëm të arsyeshëm. Banka duhet të jetë e aftë të shpjegojë ngjashmëritë dhe diferencat ndërmjet rezultateve të PVBMK-së, që mbulojnë të gjitha rreziqet materiale dhe kërkesën për kapital rregullator. Në rast se, gjatë procesit të shqyrtimit mbikëqyrës, është gjetur një diferencë e rëndësishme ndërmjet pritshmërive të bankës dhe llogaritjes së kërkesës për kapital të vetë bankës, banka duhet të jetë e aftë të justifikojë mjaftueshmërinë dhe natyrën gjithëpërfshirëse të metodës së aplikuar.

ANEKSI 7: Shembull i një kategorizimi sistematik të rreziqeve në PVBMK dhe metoda e përdorur e vlerësimit.

Lloji i rrezikut	Nënlloji i rrezikut	Niveli i rrezikut	Argumentimi (nëse nuk është material)	Metoda e përdorur për vlerësimin e rrezikut	...
Rreziku i kredisë	Rreziku i kredisë së kundërpartisë	shumë i lartë		Metoda e Bankës së Shqipërisë	
	Rreziku i investimeve në pjesëmarrje (*Equity risk)*	jomaterial	Treguesi i investimit në aksione në raport me totalin e aktiveve	Nuk është marrë në konsideratë	
	Rreziku i vendit	mesatar		Kufizim strikt (kufi strukturor)	
	Rreziku i titullzimit	jomaterial	Asnjë përfshirje në programe titullzimi (si emetues apo investues)	Nuk është marrë në konsideratë	
	Rreziku i përqendrimit të kredisë	i lartë		Kufizim strikt (kufi strukturor) dhe monitorim i shtuar	
	Rreziku i mbetur pas teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë	mesatar		Vlerësim cilësor, zvogëlim i rreziqeve duke u bazuar tek proceset (përdorimi i kontratave standarde, parimi i "katër syve", rivlerësimi i kolateraleve rregullisht etj)	
Rreziku i tregut	Rreziqet e tregut në librin e tregtueshëm	i ulët		Metoda e Bankës së Shqipërisë	
	Rreziku i kursit të këmbimit në librin e bankës	mesatar		Metoda e Bankës së Shqipërisë	
Rreziku i normave të		i lartë		Modeli VAR *(Value at Risk)*	

interesit në librin e bankës					
Rreziku operacional		mesatar		Metoda e Bankës së Shqipërisë	
Rreziku i likuiditetit të tregut		i ulët		Masa cilësore	
Rreziqet e tjera	Rreziku strategjik	i ulët			
	Rreziku reputacional	i ulët			
	Rreziku i kapitalit	mesatar		Metoda e Bankës së Shqipërisë	
	Rreziku i të ardhurave	i ulët			

ANEKSI 8: Shembuj tipikë të rreziqeve që nuk mbulohen tërësisht nga kërkesa minimale për kapital

Disa shembuj të rreziqeve që bankat duhet të konsiderojnë në vlerësimin e rreziqeve që nuk mbulohen tërësisht nga kërkesa minimale për kapital, jepen më poshtë:

1) përdorimi jo me efektivitet i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, të cilat gjenerojnë rreziqe shtesë të lidhura me rrezikun ligjor (dokumentimin) dhe likuiditetit (ekzekutimi eficient) të mjetit të përdorur për qëllim të zbutjes së pozicionit;
2) Nënvlerësimi i rrezikut të kredisë si rrjedhojë e përdorimit të vlerësimit të rrezikut të kredisë nga institucionet e jashtme të vlerësimit të kredisë, veçanërisht për kategorinë *"Investment Grade"*[3];
3) Nënvlerësimi i ekspozimit nga rreziku i kredisë në rastin e portofolit të kredive për shtëpi, sipas përcaktimit rregullator, veçanërisht në kushtet e rënies së tregut të pasurive të paluajtshme dhe ekzistencës së një tregu të brendshëm jolikuid.
4) Nënvlerësimi i rrezikut operacional në rastin e një të ardhure neto të ulët nga veprimtaria bankare, që nuk përmbush siç duhet një vlerësim të përshtatshëm të ekspozimit të bankës nga rreziku operacional, apo kompensimi i pozicioneve të të ardhurave sipas linjave të biznesit dhe rrjedhimisht gjenerimi përfundimtar i një rezultati të papërfillshëm pozitiv nga linjat e biznesit, edhe pse banka mbetet njëlloj e ekspozuar ndaj rrezikut operacional.

[3] Eksperienca e viteve të fundit ka treguar për një faliment edhe të shoqërive/institucioneve etj. të vlerësuara nga A në AAA.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"

Çmimi 392 lekë